


Aleksandra Stefanović Dijana Lucellshvab Nada Ivanović


KULTURA MUZIKORE

Për klasën e pestë të shkollës fillore nëntëvjeçare

Manuali metodik i mësuesit



Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore
PODGORICË, 2009



Aleksandra Stefanović Diana Lucelshvab Nada Ivanović

Kultura Muzikore 5

Për klasën e pestë të shkollës fillore nëntëvjeçare
Manuali metodik i mësuesit

Muzička kultura 5


Za 5. razred devetogodišnje osnovne škole
Metodski priručnik za nastavnike

Botuesi	Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore; Podgoricë
Kryeredaktore dhe redaktore përgjegjëse	Natasha Zhivković
Redaktore	Mira Popović
Recensentë	Dr. Vesna Vučinić Mr. Dobrilla Popović Nevenka Petričević Radovan Damjanović Zorica Minić
Përkthyes	Dimitrov Popović
Ilustrues	Dushan Llakiqević
Disenjoja	Vasilija Uskoković – Studio "Mouse"
Grafika e notave	Olivera Dakić
Redaktor teknik	Rajko Radulović
Për botuesin	Nebojša Dragović
Shtypi	Studio "Mouse" – Podgorica
Tirazhi	50
ISBN	978-86-303-1426-1

Këshilli i Arsimit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 04-03-172, të datës 29.08.2008, miratoi këtë Tekst Mësimor për përdorim në shkollat fillore nëntëvjeçare.

Përmbajtja:

Parathënie	4
Dinamika , B. Tomerlin, <i>Zogu i humbur</i>	16
N. Hercigonja, <i>Pëshpëritje</i>	17
Tempo, A. Stevanoviq, <i>Vrapimi</i>	18
S.P. Korunoviq, <i>Miu dhe qumështi</i>	20
Shkalla f-dur, S. P. Korunoviq, <i>Ariu Mishko</i>	21
Shkalla g-dur, <i>Tani dimër më nuk ka</i> , Këngë popullore nga Italia,	22
Prima dhe sekonda volta, B. Iliq, <i>Këndojmë</i>	23
S. P. Korunoviq, <i>Dragoi</i> , valle muzikore	24
Pjesa e theksuar dhe e patheksuar e masës	25
Masa 4/4, M. Millanoviq, I. Stamaq, <i>Maestral</i>	26
Nota katërshe me pikë, J. Genov, <i>Pranvera</i>	27
Nota gjashtëmbëdhjetëshe, K.Babiq, <i>Ketri</i>	28
Muzika popullore në Mal të Zi	30
Instrumentet popullore	32
<i>Këta të dy, bredh e pishë</i> , këngë popullore nga Mali i Zi	33
<i>Mirë se vini, dasmorë të stolisur</i> , këngë popullore nga Mali i Zi	34
<i>O dritare, o helmi im i hidhur</i> , këngë popullore nga Mali i Zi	35
<i>Tre beqarë kalojnë rrugës</i> , këngë popullore nga Mali i Zi	36
<i>Smilaniq, o të janë lagur puplat</i> , këngë popullore nga Mali i Zi	37
<i>Fryn lehtë</i> , këngë popullore nga Mali i Zi	38
<i>Prashit vajza vreshtin</i> , këngë popullore nga Serbia	38
<i>Mes natës së heshtur dhe degëve të shpeshta</i> , këngë popullore nga Serbia	39
<i>Nën manaferrë</i> , këngë popullore nga Kroacia	40
<i>Si vjen dimri, vjen zamani</i> , këngë popullore nga Shqipëria	41
<i>Pranvera në pyll</i> , këngë popullore nga Finlanda	42
R. Zverko, A. Kabilo, <i>Të qeshurit nuk është mëkat</i>	43
S. Raiçiq, Xha Androja, <i>Brumbujt dhe bletët</i>	44
<i>Në shkronjë</i> , këngë angleze	44
Motivi dhe fjalia muzikore	45
Periudha	46
Kënga dypjesëshe dhe tripjesëshe	48
Tema me variacion	49
Instrumentet muzikore	51
Dëgjimi i muzikës	53



Parathënie

Lënda e kulturës muzikore për klasën e pestë të shkollës fillore nëntëvjeçare hap një cikël të ri të përvetësimit të dijeve në klasat më të larta duke u futur më thellë në artin muzikor dhe në vetë fenomenin e muzikës. Programi mësimor artikulon lëndën përmes shumë fushave të cilat lidhen mes veti: teorinë e muzikës, format muzikore, folklorin muzikor, instrumentet muzikore, punimin e këngës sipas tekstit të notave, dëgjimin, ekzekutimin e muzikës dhe krijimtarinë muzikore. Për këtë arsye është e nevojshme që të formulohet qartë dhe saktë qasjen metodike të secilës fushë dhe të vendosim kuadrin metodik, në të cilin mësuesi do ta punojë lëndën me krijimtari dhe do të jetë i motivuar për kontributin individual në sëndërtimin me cilësi dhe sasi të lëndës, në raport me materialin e kompletit mësimor.

Udhëzimet metodike në këtë drejtim do të jenë të artikuluar për çdo fushë të përmendur në përgjithësi, duke theksuar dhe shpjeguar rregullat universale të bazuara në psikologjinë e të mësuarit dhe psikologjinë muzikore, dhe të përshkruara me shembuj konkretë nga Teksti mësimor si ilustrim i procedimit metodik paradigmatic. Meqenëse lënda e muzikës për klasën V është shumë e ngjyruar me njohjen e fenomeneve të folklorit muzikor, po fillojmë paraqitjen për procedimin metodik pikërisht në këtë fushë.

Folklori muzikor

Qëllimi i njësive mësimore që trajtojnë krijimtarinë kombëtare është njohja e nxënësve me identitetin muzikor të popullit të vet si dhe arritja e kriterëve për njohjen e krijimtarisë muzikore autentike popullore. Njohja e folklorit muzikor është e pandarë nga arritja e një pamjeje të të gjithë tipave që na rrethojnë në kuadër të të cilëve krijohet muzika në popull, d.m.th. zakonet, kalendarike dhe jokalendarike, ritualet, mitologjinë, besimin, historinë, gjeografinë, marrëdhëniet tradicionale shoqërore etj. Kështu mediumi muzikor është në njeriun popullor, mënyrën e tij të jetesës, identiteti i tij dhe direkt ndërgjegjësimi i nxënësit kur kemi të bëjmë me identitetin kulturor.


Në pjesën hyrëse të orës, mësuesi duhet të bisedojë me nxënësit për nocionin e të shprehurit popullor, krijimtarisë, duke bërë pyetjet: Si krijon populli, si zhvillohet ai proces, cilët janë shtytjet/arsyet për krijimtarinë popullore, në cilin kontekst ekziston mediumi artistik dhe a janë për të "artistik", a egzistojnë karakteristika të përbashkëta në të shprehurit e popujve të ndryshëm etj. Pjesa hyrëse e orës mund të hapë edhe pyetje në lidhje me profilin e artistit popullor: p.sh. si mëson muzikanti popullor, çfarë statusi, roli shoqëror ka ai. Është e domosdoshme të ndriçohet vetë momenti i krijimtarisë në popull: a mblidhet populli në ndonjë shtëpi "për të kompozuar" apo ajo gjë bëhet spontanisht, në raste të caktuara (në cilat?), si do të duhej të dukej vetë procesi krijues, nëse në procesin krijues marrin pjesë shumë njerëz apo vetëm një, nga i kanë "njohuritë muzikore" dhe kështu me radhë. Meqenëse kjo problematikë punohet vetëm në një njësi mësimore, mësuesi do të fokusohet në pyetje të ndryshme dhe në çdo njësi mësimore pasardhëse do të realizojë sëndërtimin (mësimin shtesë).

Lidhja kreative mundet përmes mjeteve (vizuale, muzikore etj.) të fusë problematikën konkrete të njësive mësimore (incizim i valles, instrumenteve popullore etj.).

Njëra nga detyrat më të rëndësishme të pjesës qëndrore të orës është të vendosë urën mes materies që nxënësve mund t'u duket e huaj, anakronike, dikur edhe pangjyrë, dhe botës së tyre, mënyrës së të menduarit, sistemit të vlerësimit dhe t'i hapë për botën e jetës dhe krijimtarisë popullore, të vendosë lidhje empatike me njeriun popullor. Krahas futjes në kontekst të muzikimit popullor, të tipave të rrethanave në kuadër të cilëve bëhet muzikimi si dhe të rëndësisë që ka muzika në kontekstin e jetës së popullit, tek nxënësit formohet baza e kuptimit të karakteristikave specifike të muzikës folklorike si dhe zbatimi i kriterit të veçantë gjatë përjetimit dhe vlerësimit të saj.

Procedimi metodik do të jetë në atë drejtim tregues i shembullit muzikor paradigmatic, d.m.th. lidhja e karakteristikave të shembullit muzikor (të zbuluara gjatë dëgjimit analitik¹) me rrethanat, në kuadër të të cilave praktikohet një tip i tillë muzikimi (p.sh. vajtimet: përse është mediumi vokal, tipi i melodisë, teksti, mënyra e ekzekutimit etj). Pavarësisht nga fokusi i ngushtë i temës së njësive mësimore (kënga, vallja etj.) është e rëndësishme të artikulojmë qartë figurën specifike të krijimtarisë popullore përmes territoreve gjeografike në kuadër të të cilave ato janë relativisht homogjene (p.sh. pjesët e ndryshme të Malit të Zi). Një muzikë e tillë mund të kompletohet përmes dëgjimit analitik të shembujve muzikorë paradigmaticë, gjë që do të rezultojë me njohjen e karakteristikave specifike muzikore të mënyrës së të shprehurit të popullit në territore

¹ Shihni veçanërisht kapitullin në vazhdim



gjeografike të ndryshme dhe në kuadër të kategorive të vërtetuara të muzikimit (p.sh. këngët e dasmave në Mal të Zi, Serbinë Jugore). Me atë proces, nxënësit do të njihen më thellë edhe me shenjat specifike të njeriut popullor. Pjesa qendrore e orës duhet të artikulojë disa kualifikime të lidhura me muzikimin popullor, klasifikimin e rrethaneve në kuadër të të cilave krijohet (traditat- kalendarike, jokalendarike, të vjetra, të reja etj., tipat e krijimtarisë muzikore (muzika instrumentale, vokale, vallet etj.), idiomi gjeografik etj.

Procedimi metodik fut dy qasje kryesore (të cilat mund të kombinohen): që nga njohja me kontekstin (traditat etj.) drejt futjes në shembullin muzikor dhe njohjes së lidhjes me kontekstin në kuptimin e të shprehurit të tij specifik muzikor ose përmes vetë shembullit muzikor (i cili edhe mund të tregohet me incizimin muzikor ose direkt) ka konteksti.

Procedimi metodik gjatë punimit të instrumenteve popullore është i ngjashëm me atë standard², për atë se nuk mund të lihet mënjanë lidhja me kontekstin e zbatimit të tij (si edhe krijimin, punimin etj.).

Kur kemi të bëjmë me vallen popullore, përveç dimensionit kontekstual dhe muzikor (vokal, instrumental, vokalo-instrumental), mësuesi duhet t'i njohë nxënësit me radhën e komplikuar (zgjeruar) të lëvizjeve, d.m.th. koreografisë, çfarë duhet ta lidhë me natyrën e ritualit nga i cili ka rrjedhur. Veçanërisht gjatë punimit të njësive mësimore, të cilat të futin në problematikën e valleve popullore, është e domosdoshme t'i kushtohet vëmendje e veçantë (në pjesën hyrëse të orës) fenomenit të vallëzimit në përgjithësi, d. m.th. fenomenit të të shprehurit me lëvizje. Një pamje cilësore në këtë tematikë do të japë ilustrimi i mënyrave të ndryshme të të shprehurit me lëvizje, të kontekstit në kuadër të të cilit zhvillohet një i shprehur i tillë, të zhvillimit, stilizimit dhe institucionalizimit, d.m.th. zhvillimi dhe origjina e valles. Një dritë të veçantë duhet të orientojmë drejt fenomenit të valles popullore, d.m.th. tipave në kontekstin e të shprehurit me lëvizje, në kuadër të traditës popullore.

Segmenti i veshjes popullore, me rëndësinë e vet, gjatë procesit të krijimit, me karakteristikat specifike, kontekstin gjeografik është gjithashtu një kapitull që nuk mund të anashkalohej nga mësuesi, të cilin ai duhet ta thellojë sistematikisht në çdo njësi mësimore, duke e lidhur konkretisht me shembujt që punohen. Një shenjë e rëndësishme karakteristike e territoreve të caktuara gjeografike është dielekti i veçantë, idiomat, d.m.th. karakteristikat e gjuhës me të cilat shprehen grupe të caktuara njerëzish. Do të ishte ideale kur mësuesi në shikimin e të shprehurit muzikor popullor të kyçte edhe këtë segment. Është e dëshirueshme që mësuesi (përmes dëgjimit analitik të shembujve muzikorë) të bëjë krahasimin mes traditave të vjetra dhe të reja muzikore, të trajtave të vëzhguara të krijimtarisë popullore, gjë që tek nxënësit ndërgjegjëson gjenezën e praktikës muzikore të caktuar (aktuale), por edhe krijon kriterin për njohjen dhe vlerësimin e folklorit muzikor në të ardhmen.

Pjesa përfundimtare e orës, pas shqyrtimit të arritur, duhet të artikulojë karakteristikat e njeriut popullor, të dallojë identitetin e tij në karakteristikat e të shprehurit të tij muzikor dhe të bëjë pyetje për atë se duke njohur njeriun popullor, a e njohim edhe veten.

² Të shihet kapitulli mbi procedimin metodik të punimit të instrumenteve muzikore

Dëgjimi i muzikës

Dëgjimi i muzikës në shkollën fillore mund të jetë një pjesë e veçantë e orës në kuadër të njësisë mësimore të përbërë, e cila përfshin punimin e këngës (me vesh ose me tekstin e notave) në dëgjimin e muzikës në kuadër të njësisë mësimore ku shembujt me zë janë përdorur me qëllimin e ilustrimit të "problemit" të caktuar muzikor (instrumenti, tipi formal etj.)

Segmenti i orës *dëgjimi i muzikës* përbëhet nga dy pjesë: demonstrimi dhe punimi analitik i shembullit qendror të zëshëm³. Demonstrimi ka si qëllim njohjen me procesin e dëgjimit aktiv dhe analitik të muzikës përmes një veprë të caktuar muzikore (kompozim demonstrues), i cili do të zbatohet gjatë dëgjimit të kompozimit në vazhdim ose kompozimeve.

Dëgjimi analitik i kompozimit të demonstruar zhvillohet sipas pikave më poshtë: përmbajtja e kompozimit, instrumentet, tempi, melodia, dinamika, forma, karakteri i veprës.

1. Përmbajtja e kompozimit

Mësuesi informon nxënësit për kompozimin që do të dëgjojnë, përmbajtjen e tij etj. Bën pyetjet për paraqitjen e tyre në këtë përmbajtje muzikore

2. Zgjidhja e instrumenteve

Mësuesi informon nxënësit mbi instrumentet që ka zgjedhur kompozitori për përmbajtjen veprës së vet, shpjegon zgjedhjen e atyre instrumenteve, pyet se a do të paraqiste të njëjtën përmbajtje në të njëjtën mënyrë përdorimi i instrumenteve të tjera⁴ dhe nxjerr konkluzionet për atë se si nga zgjedhja e instrumenteve dhe kombinimi i tyre në kumbim të përbashkët, varet se a do të jetë e paraqitur me besnikëri ideja e caktuar, gjegjësisht përmbajtja.

3. Tempi i kompozimit

Mësuesi komenton tempin e kompozimit, bën pyetje për atë se si e njëjta përmbajtje do të kumbonte në një temp të ndryshëm nga origjinali⁵ dhe nxjerr përfundimet se ideja e caktuar kërkon tempin e përshtatshëm në të cilin duhet të jetë e shprehur.


4. Melodia

Mësuesi komenton melodinë, karakteristikat e saj (p.sh. lëvizjen graduale, lëvizjen me kërcim etj.) dhe i sjell në lidhje me përmbajtjen, karakterin e kompozimit.

³ Mund të jenë shumë shembuj të zëshëm pas demonstrimit, por procedimi metodik është i njëjtë.

⁴ Përveç pyetjeve se ç' do të ndodhte sikur kompozitori të zgjidhte ndonjë instrument tjetër, është shumë e dobishme që mësuesi ta demonstrojë atë edhe me mendjemprehtësi, duke zgjedhur një instrument që nuk i përgjigjet karakterit të kompozimit të dhënë.

⁵ Gjithashtu me demonstrim ekspresiv



5. Dinamika, agogjika, mënyra e ekzekutimit në përgjithësi

Mësuesi komenton dinamikën, karakteristikat specifike të mënyrës së ekzekutimit (p.sh. ngadalësimin ose përshpejtësimin, *rubato*, thekset etj.) dhe bën lidhjen me shembullin konkret muzikor, gjegjësisht përmbajtjen, bën pyetje se si do të dukej kjo përmbajtje në një dinamikë tjetër, mënyrës së ekzekutimit dhe nxjerr përfundimin se si ideja e caktuar kërkon formë të caktuar interpretimi.

6. Forma

Pas pjesës së dëgjuar, mësuesi komenton temat, pjesët e kompozimit, duke treguar ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre si dhe mjetet dhe proceset me të cilat është arritur (melodia, ritmi, dinamika, agogjika etj.).

7. Karakteri i veprës

Në bazë të analizës të të gjithë komponentëve muzikorë dhe mjeteve shprehëse për karakterin e veprës (lirike, dramatike etj.) përfundon se përshypjen e përgjithshme për veprën kompozitori e realizon me modelime të kujdesshme të çdo komponenti të veçantë muzikor dhe duke i dhënë kuptim mjeteve muzikore shprehëse si edhe ndërrimin e përshypjes për veprën muzikore, në qoftë se do të ndërrohej cilado prej tyre.

Secila nga këto pika kërkon dëgjim të pjesës së veçantë të kompozimit të demonstruar (vetëm nëse mësuesi vlerëson se shembulli është i thjeshtë dhe se mund të realizojë dy paragrafe gjatë një dëgjimi). Është e rëndësishme që mësuesi para çdo dëgjimi, t'ua drejtojë vëmendjen nxënësve se ku duhet të fokusohen, kështu që vëmendja e tyre gjatë dëgjimit të jetë e orientuar qëllimisht. Gjatë punimit të paragrafeve të caktuara, mësuesi duhet disa herë të dëgjojë segmentin e caktuar të kompozimit (ose gjithë shembullin) me qëllim që të paraqesë qartë dhe në tërësi problemin e caktuar.

Pas këtij demonstrimi, i cili është hyrje në dëgjimin e muzikës, mësuesi kalon në kompozimin qendror (ose shumë sish) të zgjedhur për dëgjimin analitik të muzikës, në kuadër të të cilit nxënësit marrin pjesë aktivisht. Procedimi është i ngjashëm si në demonstrimin, me ndryshimin se tani mësuesi nuk përshkruan karakteristikat e synuara të rrjedhës muzikore: këtë gjë kësaj radhe e bëjnë nxënësit, ashtu që mësuesi para çdo dëgjimi jep detyra të veçanta, ndërsa ata krahas dëgjimit i zbulojnë.

Detyrat gjatë dëgjimit analitik të muzikës:

- njohja e përbërjes së ekzekutimit;
- përshkrimi i linjave melodike dhe ritmike, tempit; dinamikës, agogjikës, mënyrës së ekzekutimit; formës; dhe
- përshkrimi i karakterit të tërësishëm.

Nxënësit kësaj radhe nuk dijnë se cilat vepra do të dëgjojnë. Para çdo dëgjimi, mësuesi do t'u japë detyrën e caktuar dhe do t'i lëjë të dëgjojnë muzikën aq gjatë⁶ sa u duhet për të dalluar problemin e caktuar. Gjatë bërjes së pyetjeve është e domosdoshme që t'u ofrohen (para dëgjimit) disa përgjigje të mundshme që nxënësit të kishin të qartë paraqitjen për atë se çfarë kërkohet tamam prej tyre, për t'u kufizuar në problemin që kërkohet, si edhe për të qenë të njohur me spektrin e mundësive shprehëse të segmentit që është në fokusin momental⁷, p.sh. a është melodia e kënduar, me kërcim, a mund të kërcëhet me të, a është lirike apo dramatike, e gjallë apo e qetë etj⁸. Në kuadër të përgjigjeve të ofruara, do të ishte mirë që gjithnjë ta linin "bosh" një vend "ose ndonjë karakteristikë që nuk e kemi futur, ndërsa ju e vëreni" për të motivuar nxënësit që kurdoherë vetë ata mund t'i kontribuojnë zbulimit të mundësive kreative, si dhe të mendojnë aktivisht, në vend se "t'u serviren" të gjitha përgjigjet e mundshme.


Kur nxënësit të jenë përgjigjur në të gjitha detyrat e dhëna, sigurisht kanë përshkruar veprën muzikore përmes karakteristikave "fizike" të saj, mësuesi bën pyetje (përsëri me përgjigje të ofruara) për përshtypjen e përgjithshme të veprës muzikore dhe për karakterin e saj. Dhe taman në këtë moment, nëse nxënësit japin përgjigjet e duhura, qëllimi është i arritur, nuk duhet të kërkohet prej tyre të gjejnë programin, d.m.th. asociimin jashtëmuzikor të mbresës së karakterizuar të veprës. Vetë karakteri i përshkruar, i cili është rezultat i bashkëveprimit muzikor mund të zbatohet në një numër më të madh të situatave jashtëmuzikore, dhe që edhe më tej të jetë i "saktë" (p.sh. mjellma, ndonjë kujtim, ditë pranvere, personi). Kulmi është tamam në momentin kur nxënësit, në procesin e dëgjimit analitik kanë kaluar përmes shumë dimensionesh muzikore: strukturës, elementeve shprehëse, procesit të kompozimit, që kanë përcjellë duke arsyetuar edhe anën estetike, çfarë është arritje e përvojës të zgjeruar e të shumëllojshme për mënyrën se si shprehet njeriu në muzikë. Pasi nxënësit e kanë karakterizuar përshtypjen e tërësishme të veprës, d.m.th. karakterin, mësuesi mund t'u tregojë edhe përmbajtjen jashtëmuzikore, origjinën e veprës, kontekstin e gjerë dhe atëherë së bashku, edhe njëherë në tërësi dëgjojnë shembullin e dhënë muzikor, krahas udhëzimeve të herëpashërëshme të mësuesit në momente të caktuara të rëndësishme. Qartë "gjetja" e programit, titullit të kompozimit nuk duhet të jetë vetëm ky qëllimi i juaj.

Ka rëndësi të përmendim se përvoja e të dëgjuarit të muzikës, si një ndër rrugët e zbulimit të mediumit muzikor, nuk duhet të lidhet "vetëm" me muzikën programore, sepse përmbajtja jashtëmuzikore nuk është as vendimtare, as e domosdoshme për krijimin e veprës muzikore, e cila nuk duhet të lidhet me asociimet programore. Një mekanizëm të tillë nuk duhet ta krijojmë tek nxënësi. Muzika ka jetën e vet të brendshme. Rrjedha e saj është e modeluar me dramaturgjii specifike dhe pikërisht, me zbulimin e ekzistencës, funksionimit dhe bashkëveprimit reciprok të elementeve muzikore, mësuesi ua zbulon nxënësve botën e muzikës. Për udhëheqjen e tregimit për asociimet, mësuesi nuk është i domosdoshëm. Në atë kuptim ai duhet gjithnjë që të balancojë zgjedhjen e kompozimeve për dëgjim, në kuadër të të cilit do të jenë njësoj të përfaqësuara kompozimet e karakterit programor dhe "absolut".

⁶ Gjatë dëgjimit të pjesëve do të ishte e udhës që shembulli të jetë gjithmonë ndonjë tërësi e vogël, relativisht e kufizuar.

⁷ Në praktikë bëhen shpesh këto pyetje vetëm për të plotësuar formën, por që të mos mendohet për përshtashmërinë e tyre, ashtu që kur bëhet pyetja *Si është melodia*, ndërsa nuk ofrohen përgjigjet, fitohet spektri më i gjerë i mundshëm i përgjigjeve, të cilat kanë efekt në kontekstin e arritjes së qëllimit të dhënë. Për shembull: "Melodia më përkujton në kohën kur kam ngrënënjëra pas tjetrës..." ose "si ndonjë princeshë, e cila" ... etj.

⁸ Është me rëndësi të thuhet që të anashkalohej "detyrimi" i nxënësve në pyetjet e tipit: hidhëruar/gëzuar, mirë/keq, etj., sepse kjo do të ishte futje në përjetimin e vet (çfarë është për një person e hidhur, nuk duhet të jetë edhe për tjetrin), ndërsa mund të jetë edhe ndonjë melodi "e gëzuar" të cilën mund ta vërejmë në një pjesë të caktuar të lidhur me ndonjë moment biografik tragjik të kompozitorit.



Punimi i këngës

Mësimi i këngës me dëgjim

Procedimi metodik i mësimi të këngës me vesh përbëhet nga disa segmente:

1. Këndojmë

Mësuesi me nxënësit do të këndojë këngën (ose disa këngë) që janë të njohura për nxënësin (mund të fillojë vetë ekzekutimin në instrument, kurse ata kyçen më vonë, pasi e kanë njohur).

2. Mësimi me fraza

Mësuesi së pari e ekzekuton vetë këngën, nën shoqërimin instrumental. Këngën që do ta dëgjojnë nxënësit mund ta dëgjojnë së pari edhe nga një ekzekutim i incizuar ose drejtpërdrejt nën ekzekutimin e disa këngëtarëve të njohur, të cilët kanë ardhur me atë qëllim në orë.

Në varësi nga përbërja e këngës së zgjedhur, mësuesi përcakton gjatësinë e fragmentit që do t'u këndojë së pari nxënësve, pastaj do të kërkojë që ata ta përsërisin. Gjatësia e fragmentit duhet të jetë një tërësi mikrologjike, varg ose gjysmëvarg, d.m.th. sintagmë muzikore, gjysmë fjali ose fjali. Mësuesi gjithmonë ekzekuton fraza në tempin e caktuar dhe shprehimisht, ashtu siç do të duhej të tingëllonte në ekzekutimin final. Procesi i mësimi të këngës sipas frazave mbështetet me përcjellje instrumentale, e cila krahas mbështetjes së zhvillimit të dëgjimit harmonik lehtëson këndimin e melodisë, dallimi i komponentit harmonik muzikor, ndikon në përjetimin estetik të këngës etj. Kur mësuesi vëren ekzistencën e problemit gjatë ekzekutimit të ndonjë segmenti në frazë, kthehet në atë vend dhe e ekzekuton pa shoqërim, duke e përsëritur aq gjatë sa është e nevojshme që nxënësit ta ekzekutojnë rregullisht.

3. Ekzekutimi në tërësi i këngës me shoqërim instrumental

Në këtë moment mësuesi duhet edhe veçanërisht t'ua tërheqë vëmendjen nxënësve në elementet e të shprehurit krahas sqarimit (bindjes) së detyrueshme në lidhjen mes lidhjes së tekstit dhe mjeteve⁹ shprehëse muzikore.

4. Sëndërtimi

Kur mësuesi e vlerëson se nxënësit e kanë përvetësuar këngën, gjatë ekzekutimit të këngës në vazhdim kushtëzon edhe përcjelljen instrumentale; qoftë në kuptimin e mediumit (fut instrumentet e reja, ansamblin kamertal, orkestrën, instrumentet e Orfit etj.), qoftë në kuptimin harmonik e fakturor, ose stilistik (me elementet e xhazit, impresioniste, etno etj.), duke pasur kujdes që të mbetet në kuadrin estetik të origjinalit.

⁹ Të shihet më detajisht në tekstin në vazhdim koncepti i njësisë mësimore *Punimi i këngës dhe dëgjimi i muzikës*

Të mësuarit e këngës me tekstin e notave

Procedimi metodik gjatë mësimit të këngës sipas tekstit me nota është më i ndërlikuar se punimi i këngës me dëgjim.

1. Analiza e tekstit me nota

Nxënësit duhet të kenë të njohur tempin, taktin, bazën e shkallës, shenjat e përsëritjes etj. Nëse në tekstin me nota vërehen figura specifike ritmike, mësuesi i vërteton me nxënësit.

2. Leximi ritmik i tekstit me nota (krahas taktimit) në rrokjen neutrale (gjë që mund të kalohet në leximin rimik të tekstit me nota me solmizim, në qoftë se ritmi është i thjeshtë dhe nxënësit të praktikuar).


3. Leximi ritmik i tekstit me nota

4. Këndimi sipas motiveve melodike nga kënga që punohet, në trezërësha të ndarë të shkallëve kryesore. Kur punohet me nxënës të klasave të ulëta, tek të cilët veç sa ka filluar procesi i zhvillimit të dëgjimit në kontekstin e arsimimit të përgjithshëm, është e nevojshme në fillim të zgjidhen këngët me strukturë të thjeshtë harmonike dhe melodike.

5. Të kënduarit e këngës me solmizim

Ky është momenti më kërkues, sepse, ndërsa nxënësit mësojnë këngën me solmizim zhvillon dhe vërteton dëgjimin e tyre; nxënësit këndojnë melodinë e këngës, ndërsa mësuesi ekzekuton qartë shoqërimin e thjeshtë, të artikuluar dhe harmonik (rëniën me akorde të funksioneve themelore harmonike) me të cilën mbështet ekzekutimin melodik të tyre. Esenca e këtij procesi është që të degëzohet të mësuarit me dëgjim- kur nxënësit *do të përsëritnin* atë që dëgjojnë dhe ekzekutimi i melodisë si rezultat i zhvillimit të dëgjimit të tyre. Prandaj edhe duhet që në fillim të zgjidhen këngët më të thjeshta dhe në mënyrë graduale të kushtëzohet ajo zgjedhje.

Kur shfaqen probleme në lidhje me intonimin e një pjese të caktuar të këngës, mësuesi duhet së pari të vërtetojë se për cilin lloj të problemit është fjala dhe për këtë të zgjedhë ushtrime të caktuara me ndihmën e të cilave do të mund ta zgjidhë problemin. Spektri i problemeve të mundshme është i gjerë, duke filluar nga baza e shkallëve stabile dhe jostabile në shkallën muzikore, kalimeve në to, lëvizjeve melodike specifike, (të shkallës, të akordit, të tercinës etj.), si edhe kombinimet specifike me problemin ritmik në melodi. Mësuesi së pari duhet ta izolojë atë problem dhe të ushtrojë me nxënësit deri sa të arrijë përshtypjen se e intonojnë në mënyrë të stabilizuar. Hapi i mëtejshëm është në lidhjen direkt me kontekstin në vetë melodinë e këngës. Kur është përvetësuar edhe kjo, mësuesi do të kthehet në tërësinë logjike muzikore, e cila i paraprin vendit problematik dhe ekzekuton të gjithë frazën, pjesën më të madhe ose të gjithë këngën.



6. Këndimi i këngës me tekst

Kur nxënësit e kanë përforcuar plotësisht këndimin e tekstit me nota, duke respektuar të gjitha shenjat (dinamike, agogjike etj.) këndohet kënga me tekst. (Deri në atë moment, teksti i shkruar poshtë çdo takti mund të jetë i mbuluar, por gjatë shprehisë në punimin e këngës sipas tekstit me nota, ky procedim nuk duhet të zbatohet.).

Procedimi i mëtejshëm është identik me punimin e këngës me dëgjim; pikat nr.3 dhe nr.4.

Punimi i këngës dhe dëgjimi i muzikës

Gjatë punimit të njësisë mësimore në kuadër të së cilës mësohet kënga dhe dëgjohet muzika, në pjesën hyrëse të orës hapen çështje esenciale të veçanta të lidhura me vetë fenomenin e muzikës dhe të cilat do ta ndriçojnë pjesën qendrore nga kënde të ndryshme. Këto çështje mbeten aktuale jo vetëm gjatë punimit të kësaj njësie mësimore, por edhe në çdo njësi të re, gjatë të gjithë vitit shkollor. Shkak për këtë është se ato janë të lidhura direkt me vetë identitetin e njeriut dhe mënyrat e ekzistencës dhe të shprehurit të tij, çfarë është tema shekullore filozofike, psikologjike, teologjike, antropologjike, shkencave natyrore etj. Pjesa hyrëse e orës është vendi më optimal i shtrimit të atyre pyetjeve, të cilat do të jenë fokusi kryesor në pjesën qendrore, ndaj porositim që pjesa hyrëse të mendohet e tillë veç pasi vetë mësuesi ta ketë artikulluar qartë qëllimin e punimit të këngëve të veçanta dhe kompozimeve për dëgjim.

Qëllimi i kuptimit qendror të ilustrimit të orës në vazhdim është që të tregojë bash në ato pyetje esenciale që mësuesi shtron në pjesën hyrëse dhe mënyra e lidhjes problemore të të gjitha veprimtarive gjatë orës deri në kthimin eksplicit në pyetjet e shtruar në fillim, por me përvojat e reja muzikore të arritura, si edhe me dritën e re me të cilën këto pyetje janë ndriçuar.

Mësuesi do të zgjedhë një temë konkrete (e cila mund të jetë e lidhur me tekstin e këngës që do ta punojë në pjesën qendrore të orës) dhe do të tregojë se si në mënyra të ndryshme është treguar po ajo temë në artet e ndryshme (pikturë, skulpturë, poezi). Do të bisedojë me nxënësit për llojshmërinë dhe ndryshueshmërinë e të treguarit, të shprehurit të po asaj teme nga artistë të ndryshëm në kuadër të arteve të ndryshme. Do të theksojë se të gjithë artistët kanë pasur idenë dhe se ajo është bërë vepër artistike të cilën mund ta përjetojmë me shqisat tona.

Më në fund kalon fenomeni i *idesë* së artistit, duke futur edhe nocionin e *frymëzimit* dhe orienton vëmendjen në procesin e krijimit të idesë e deri tek realizimi i veprës artistike.

Mësuesi i fut nxënësit në pjesën qendrore të orës me pyetjen se si artisti mund ta realizojë idenë e vet përmes muzikës. Një shembull i tillë konkret është kënga të cilën do ta mësojnë së bashku (mund të jetë tema e përmendur, por edhe mund të mos jetë ajo, është e rëndësishme që ajo të vështrohet në kontekst të këtyre nocioneve themelore), por me kushtin që tani vetë nxënësit të jenë ekzekutuesit. E këndon këngën në mënyrë ekspresive me shoqërim instrumental. Sipas nevojës ua lexon edhe një herë tekstin dhe e çon bisedën për përmbajtjen konkrete të këngës: p.sh. si duhet të ishin karakteristikat e këngës, pavarësisht nga tema për të cilën flet kënga. Vazhdon procesi i mësimin të këngës. Kur e kanë përvetësuar këngën, menjëherë gjatë tregimit të elementeve të të shprehurit ekspresiv të këngës, nxënësve përsëri u tregohen karakteristikat e përmbajtjes së treguar, që edhe në atë kuptim të modelohet ekzekutimi i saj.

Me pyetjen se si do të shprehej ideja e artistit në muzikën instrumentale, mësuesi kalon në hyrjen në dëgjimin e kompozimit të demonstruar (i cili përsëri mund të ketë lidhje me temën nga pjesa hyrëse e orës) dhe vazhdon me dëgjimin e kompozimeve të zgjedhura duke e krahasuar me të njëjtën ide, por në vepra artistike të ndryshme. Në fund nxënësve u jep detyrë, i nxit të mendojnë se si ata do ta shprehnin një ide të veten, përmes medimeve artistike të ndryshme, nga të cilat njeri është ai i muzikës.

Instrumenti

Qëllimi i njësive mësimore që punojnë instrumentet, është njohja me karakteristikat e tyre dhe aftësimi i nxënësve për dallimin e tyre (si nga tingulli, ashtu dhe nga pamja). Qëllim i veçantë i punimit të instrumentit është që nxënësit të njihen me karakteristikat e tij, që të arrijnë bazën fillestare gjatë punës krijuese; p.sh. gjatë bisedës me mësuesin në lidhje me pasqyrimin muzikor të zotit, nxënësi, midis tjerash, duhet ta zgjedhë instrumentin.

Gjatë punimit të instrumentit muzikor si temë e njësisë mësimore, në pjesën hyrëse të orës, mësuesi së pari duhet të përsëritë me nxënësit se cilat grupe instrumentesh ekzistojnë si dhe grupin e caktuar të instrumenteve (ose instrumentin). Çfarë do të rindërtojë detajisht varet nga tipi i instrumentit, të cilin do t'ua tregojë detajisht në pjesën qendrore të orës, d.m.th. se cila është tema e njësisë mësimore. Për shembull, nëse tema është organoja, do të përsërisë grupin e instrumenteve frymore; nëse është klarineti, do të përsërisë oboan etj. Kjo ripërtëritje nuk parasheh përsëritjen automatike të krejt asaj që është mësuar për instrumentin në fjalë, por ato karakteristika që kanë lidhje me instrumentin që do të mësohet në pjesën qendrore të orës, p.sh. lidhja mes ndërtimit dhe mënyrës së fitimit të tingullit, teknikat e veçanta etj.


Spona kreative është një procedim i veçantë që instrumentin në fjalë e fut në pjesën qendrore të orës. Kjo mund të realizohet me shembullin e veçantë të zëshëm- ndoshta me ndonjë që nxënësve do t'u dukej më i afërt (p.sh. organot në një kompozim të ndonjë grupi muzikor të dëgjuar, tema e një filmi të dëgjuar etj., sekuencat nga ndonjë film, pikturë, me një bisedë të veçantë etj.

Momenti i fillimit të bisedës për instrumentin që është tema e njësisë mësimore shënon fillimin e *pjesës qendrore* të orës, kur emri i tij shënohet në tabelë. Arritja më e mirë është atëherë kur mësuesi mundëson praninë e ekzekutuesit të "gjallë", i cili direkt në instrument demonstroi atë që flet mësuesi. Procedimi metodik gjatë punimit të instrumentit përbëhet nga shumë elemente.

– Mësuesi shpjegon ndërtimin e instrumentit. Qëllimi i këtij segmenti nuk është thënia e çdo pjese, por tregimi i funksioneve të tyre gjatë muzikimit. Nëse mësuesi nuk është në gjendje të sjellë një ekzekutues me instrument, do të duhej që ndërtimin e instrumentit ta bëjë me anë të figurës.

– Vazhdon biseda e arsimtarit mbi historinë e instrumentit dhe paraardhësve të tij.

Edhe ky segment duhet menduar ashtu për të realizuar lidhjen funksionale me instrumentin që punohet (përse "paraardhësi" ose ndonjë pjesë mekanike e tij) ka "evoluar" në instrumentin e sotëm. E dhëna që nuk duhet të lihet jashtë është se a mundet sot (dhe në cilin kontekst) të ndeshim në përdorimin e elementit paraardhës, çfarë duhet ndjekur me shembull me zë duke treguar specifikat e instrumentit.



- Mundësitë tekniko-ekzekutuese të instrumentit, mësuesi (ekzekutuesi) i sqaron në përshtatje me specifikat dhe standardin e vendosur gjatë punimit të instrumentit të parë nga grupi i instrumenteve me hark (sipas planit dhe programit mësimor ky grup punohet në fillim), d.m.th. si ekzekutohet *legato*, *picikato*, tingujt alikvotë etj. Çdo element i zgjedhur ekzekutues duhet të ilustruhet me shembuj të zëshëm – mësuesi duhet që nxënësve t’u sqarojë se si arrihet cilësia e caktuar e zërit dhe atë ta tregojë në instrument ose të lëshojë një fragment në të cilin dëgjohej qartë problemi ekzistues që shpjegon.
- Mësuesi tani mund të mbështetet në ekzekutues të dëgjuar (duke futur ku mundet edhe ata malazezë) dhe do të ishte e udhës që nxënësve t’u lëshojë pjesë të ndonjë kompozimi për atë instrument me interpretime nga ekzekutues të ndryshëm, duke u treguar specifikat e tyre. Në fillim do të ishte mirë të krahasohej i njëjti shembull në ekzekutime të ndryshme, që zgjidhja e shembullit të jetë e afërt dhe e njohur për nxënësit (ndoshta diçka që është e njohur aktualisht në botën e tyre të interesimeve të përditshme). Kur të kenë arritur një farë dije në specifikat e krijimtarisë ekzekutuese dhe veçantitë, mësuesi mund të zgjerojë kriterin e zgjidhjes në varësi të idesë konkrete dhe kontekstit.
- Vijnë shikimi i grupeve ekzekutuese në të cilat merr pjesë instrumenti që punohet krahas shembujve të zëshëm për secilin dhe komentimi i rolit të tij.
- Mësuesi në mënyrë informative përmend zhanrin e koncertit solistik (pavarësisht nga ajo se ky zhanr do të mësohet në klasat më të larta). Kadencia solistike e një koncerti që mund ta zgjedhë mësuesi mund të jetë vendi ku nxënësit me ndihmën e mësuesit të vërejnë proceset e ekzekutimit në karakteristikat e përmendura të instrumentit.
- Vijnë pamja e zgjedhjeve të kompozitorëve që kanë shkruar për këtë instrument. Pavarësisht nga fakti se një numër i madh kompozitorësh ka shkruar për shumicën e instrumentave të orkestrës simfonike, duhet që mësuesi në vend të përmendjes të thotë të dhënë se p.sh. për violinën, që nga koha e krijimit të saj e deri sot ka shkruar një numër i madh kompozitorësh ose ta lidhë me zhvillimin e instrumentit kur është rritur interesimi i kompozitorëve për instrumentin e caktuar. Gjithsesi mësuesi vetë mund të zgjedhë një varg kompozitorësh, të cilët sipas kriterëve të ndryshme mund të jenë të rëndësishëm për t’ua dhënë nxënësve.
- Në praktikë ndodh shpesh që mësuesi ta lidhë një instrument për ndonjë cilësi të shprehjes, p.sh. violina është instrument lirik, tromboni është “dramatik” etj. Segment që nuk mund të anashkalohet në procedimin metodik gjatë punimit të instrumenteve është mundësia e të shprehurit të llojllojshëm të instrumentit të caktuar, e cila nuk varet kryesisht nga ndërtimi i tij, mundësitë teknike, por nga potenciali krijues dhe qëllimi i kompozitorit. Në këtë kuptim mësuesi duhet t’u japë nxënësve shembuj muzikorë (fragmente) në të cilat, i njëjti instrument mund të tingullojë lirik, tragjik, grotesk, mistik etj. ndërsa secilin nga “karakteret” mësuesi mund ta lidhë me programin (d.m.th. qëllimin e kompozitorit që një përshtypje të tillë edhe ta pasqyrojë).

Forma në muzikë


Kur problematika e formës muzikore vështrohet në kuadër të arsimimit të përgjithshëm muzikor, është e domosdoshme që mësuesi të mbështetet në dy momente kyçe:

1. çfarë është forma në muzikë dhe
2. dramaturgjia muzikore.

Fëmijët që në moshë më të vogël e kuptojnë lehtë nocionin formë në fushën vizuale ose edhe në fusha të tjera (taktilimi, kombinimet e ndryshme të llojeve të ndryshme të përjetimit); përjetimi dhe artikulimi i formës në sferën auditive zhvillohet më vonë. Në këtë kuptim është e domosdoshme që nxënësve t'u afrohet vetë nocioni i formës në muzikë- si mund ta ketë formën muzika. Ky është vërtetë një material i begatshëm për pjesën hyrëse të orës, kur punohen njësitë mësimore me problematikën e formës muzikore, me atë që mësuesi në çdo orë në vazhdim të thellojë e zgjerojë bisedën dhe shembujt për vetë fenomenin e formës në muzikë. Në pjesën hyrëse të orës, kryesisht në kuadër të njësive së parë mësimore, ku do të mësohet forma muzikore, mësuesi mund të përdorë muzikën programore dhe t'u spjegojë nxënësve atë sesi një personazh i caktuar muzikor (p.sh. mjellma ose elefanti nga Karnevali i kafshëve etj.) paraqitet, duke dëgjuar direkt temën. Vijon bisedimi për paraqitjen muzikore të atij personazhi, ku mësuesi duhet të sqarojë rrethanat specifike ose terësinë e paraqitjeve (p.sh. vetëm paraqitja e personazhit muzikor "në skenë", paraqitja e tij dhe fshehja). Mësuesi mundet në të njëjtën mënyrë të tregojë cilëndo tërësi të një rendi më të lartë (periudhën, këngën etj. pa shpjegime, vetëm sa për të arritur përjetimin) duke e lidhur për të parën ose dy njësitë e para mësimore të programit. Pas këtij afrimi fillestar, mësuesi në pjesën hyrëse do të përdorë temat ose tërësitë nga një rend më i lartë pa i lidhur me përmbajtjen e programit (ose duke kombinuar) duke përdorur termat "tema" dhe/ose "tërësia mësimore" etj.

Në pjesën qendrore mësuesi punon problematikën e dhënë duke shpjeguar sipas parimit të përshkruar në *dëgjimin e muzikës* duke shpjeguar detajisht në kuadër të kompozimit të demonstruar, për çfarë tregon lidhjen e formës muzikore me gjithë parametrat e tjerë muzikorë, duke konkluduar në fund se përse kompozitori e ka formësuar muzikën e tij bash në atë mënyrë (tamam me atë formë muzikore) duke vërtetuar kuptimin e problematikës përmes zbulimit dhe njohjes të nxënësve në kuadër të *dëgjimit analitik të muzikës*. Për dëgjimin analitik të muzikës, kur nxënësit janë më aktivë, mësuesi duhet të zgjedhë dy kompozime të shkurtra me problematikë të njëjtë si në atë të demonstruar dhe t'i udhëheqë në zbulimin e tyre, d.m.th. dallimin e problematikës me anë të të dhënave.

Në pjesën përfundimtare të orës mësuesi mund t'u japë nxënësve temën që kanë dëgjuar në pjesën qendrore, por me detyrën që të përqendrojnë vëmendjen në marrëdhënien e "atij personazhi muzikor" ose teme me një tjetër personazh muzikor dhe temë dhe të përshkruajnë se në ç'mënyrë është krijuar (formësuar) një ngjarje e tillë (p.sh.: paraqitja e temës, pastaj ndryshimi një temë tjetër/personazhi muzikor dhe përsëri tema nga fillimi, por "më fort", më bindshëm, duke rrethuar të gjithë ngjarjen). Me këto procedime nxënësve u ofrohet rritje e përvojës në përjetimin e formës muzikore me ndërjegjësimin gradual, racionalizimin e një përvoje të tillë të fituar cilësore dhe të lloj-llojshme.



Vërejtje në hyrje

Lënda Kultura muzikore në klasën V zhvillohet me dy orë në javë, gjegjësisht 70 orë në vit. Nga ky numër 60 orë janë planifikuar për punimin e lëndës mësimore. Lënda është ndarë në tërësi tematike me një numër të caktuar orësh. Bazat e teorisë muzikore (13), Muzika popullore (13), Këngë artistike (8), Format muzikore (4), Instrumentet (14), Dëgjim muzike (8).

Përgatitja e njësive mësimore është e grupuar në tërësi mësimore. Një renditje e tillë nuk është dhënë si e domosdoshme për të gjithë vitin, por mësuesi është i lirë ta krijojë sipas përvojës, afinitetit dhe aftësive të vetë nxënësve. Në përpunimin vjetor të renditjes së lëndës, mësuesi mund të ndjekë renditjen e lëndës sipas librit.

Tek të gjitha fushat mësimore janë bërë përgatitjet për të gjitha njësitë mësimore, përveç tek njësitë mësimore *Instrumentet muzikore* dhe *dëgjimi i muzikës*. Pavarësisht se me procedimin e njëjtë metodik për punimin e njësive mësimore të përfshira më lart (*instrumentet muzikore* dhe *Dëgjimi i muzikës*) është dhënë edhe nga një përgatitje tipike se si mund t'i iket përsëritjes së tekstit. Në fund të përgatitjes për dëgjimin e muzikës, në vërejtje janë dhënë propozime të veprave të cilat mund të punohen. Mësuesi gjithashtu mund të zgjedhë veprat e dhëna në programin e lëndës ose sipas zgjedhjes së vet.

Dinamika

Qëllimi mësimor:

1. fitimi i njohurive për dinamikën dhe shenjat e saj
2. mësimi i valles së re muzikore dhe ekzekutimi i saj.

Dëgjimi i muzikës:

1. B. Tomerlin, *Zogu i humbur*, lojë muzikore
2. E: Grig, *Marshi i shkurtabiqëve*
3. P. I. Çajkovski, *koncert për piano dhe arkestër në b-mol*, koha I (fragment)

Hapat kryesorë:

1. Pjesa hyrëse
2. mësimi i këngës *Zogu i humbur*, mësimi me vesh
3. mësimi i valles popullore *Zogu i humbur*
4. njohja me nocionin *dinamika* dhe shenjave për ekzekutimin e qetë dhe të fortë
5. dëgjimi analitik i muzikës

1. Në pjesën hyrëse të orës nxënësit të këndojnë ndonjë këngë të njohur.

2. Të punohet kënga *Zogu i humbur* sipas procedimit metodik për punimin e këngës me vesh.

3. Kur kënga është mësuar, u shpjegohet nxënësve se si ekzekutohet vallja. Zgjedh një nxënës – lojtar (valltar) i cili do të dalë nga klasa. Gjatë kësaj kohe nxënësit e tjerë fshehin zogun e bërë nga kartoni, të cilin e kanë përgatitur më parë në shtëpi. Kur nxënësit ta kenë fshehur zogun, nxënësi që ka qenë jashtë klase kthehet në lojë. Ai kërkon zogun, derisa të tjerët këndojnë këngën. Nëse lojtari i afrohet zogut të fshehur kënga bëhet më e fortë, ndërsa kur i largohet bëhet më e qetë. Kur lojtari e gjen zogun, atëherë rolin e tij e merr një nxënës tjetër.

4. Mësuesi atëherë do të kërkojë nga nxënësit të thonë se çfarë ndryshimesh kanë ndodhur gjatë këndimit të këngës (ka ndryshuar fortësia e zërit të këngës). Mësuesi i informon për shenjat *butë*, *fort* gjatë ekzekutimit dhe sqaron nocionin *dinamikë*.

5. Mësuesi lëshon kompozimin *Marshi i shkurtabiqëve* të E. Grigut, me synimin që nxënësit të dallojnë ndryshimet dinamike (dekreshendo dhe kreshendo- ngritja dhe ulja graduale e muzikës). Pastaj do ta lëshojë për herë të dytë muzikën për të vizatuar ose paraqitur grafikisht ndryshimet dinamike. (Mësuesi mund të kërkojë që nxënësit me lëvizje të tregojnë çfarë ndodh në kompozim, ose mund ta lidhë me fenomenet e natyrës ose shembuj nga jeta.) Atëherë mësuesi do të sqarojë nxënësit se në muzikë ekzistojnë shenjat me të cilat shënohet ngritja dhe ulja graduale gjatë ekzekutimit muzikor. Kërkon nga nxënësit të hapin Tekstin mësimor në faqen 7 dhe komenton pamjen dhe emrat e këtyre shenjave. Para dëgjimit të tretë të kompozimit do t'u thotë nxënësve se është fjala për veprën që quhet *Marshi i shkurtabiqëve* dhe shkruan në tabelë emërtimin e veprës dhe emrin e autorit. Pastaj do të lëshojë një incizim nga muzika absolute (Çajkovski: *koncert për piano dhe orkestër në b-mol*, koha I). Me nxënësit bisedon për atë se çfarë arrihet me një *dinamikë të caktuar* në muzikë (ngritje dhe ulje e dramacitetit, ndjenjave, përjetimeve, gjendjes disponuese, përshkrimit të ngjarjeve, fenomeni nga natyra etj.).


H. Hercigonja, *Pëshpëritja*

Qëllimi mësimor:

1. zgjerimi i njohurive për dinamikën
2. mësimi i këngës së re
3. mësimi i orkestrimit instrumental dhe ekzekutimi i saj.

Dëgjimi i muzikës:

1. H. Hercigonja, *Pëshpëritja*, ekzekutim vokalo-instrumental
2. H. Hercigonja, *Pëshpëritja*, ekzekutim instrumental



Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse
2. mësimi i këngës *Pëshpëritja*, mësimi me vesh
3. mësimi i shenjave të reja dinamike
4. ushtrime
5. formimi i grupeve dhe mësimi i orkestrimit instrumental

1. Në pjesën hyrëse të orës nxënësit këndojnë ndonjë këngë të njohur më parë.

2. Të mësohet kënga *Pëshpëritja*, sipas procedimit metodik me vesh.

3. Kur nxënësit ta kenë mësuar këngën, t'u jepet detyrë të dallojnë se si gjatë këndimit të kësaj kënge ndryshohet dinamika (në disa vende kanë kënduar qetë- piano, diku kanë kënduar fort-forte dhe pastaj mesatarisht ulët ose mesatarisht fort). Shikojnë Tekstin mësimor në faqen 8 dhe kërkon që të dallojnë shenjat e reja dinamike në tekstin e notave dhe i sqaron.

4. Kërkon nga nxënësit të përgjigjen në pyetjet e rubrikës: *Çfarë kemi mësuar*, në Tekstin mësimor faqe 8.

5. Pastaj mësuesi e ndan paralelen në tri grupe, për përvetësimin e orkestrimit instrumental të valles muzikore *Zogu i humbur*. Çdo grup në veçanti ushtron pjesën e vet në instrumentet e shënuara në libër, faqe 92.

Ndërsa grupet punojnë, mësuesi i kontrollon dhe do të ndihmojë sipas nevojës. Kur grupet do të ushtrorin pjesët e dhëna, më përpara do t'i ekzekutojnë ato një nga një. Pas kësaj mësuesi do të ndërrojë grupet në mënyrë alternative njëra me tjetrën dhe pastaj të gjitha grupet egzekutojnë së bashku.

Tempi

Qëllimi mësimor:

1. fitimi i njohurive për tempin
2. mësimi i këngës së re

Dëgjimi i muzikës:

1. A. Stefanoviq, *Vrapimi*, ekzekutim vokalo-instrumental
2. A. Stefanoviq, *Vrapimi*, ekzekutim instrumental
3. E. Grig, *Në shpellën e mbretit të malit*
4. T. Albinoni, *Adaxhio*

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse
2. mësimi i këngës *Vrapimi*, mësimi me vesh
3. mësimi i shenjave për tempin
4. dëgjimi analitik i muzikës
5. pjesa përfundimtare

1. Nxënësit këndojnë këngën *Pëshpëritja* dhe verifikojnë njohuritë e fituara për dinamikën.

2. Punohet kënga *Vrapimi* sipas procedimit metodik me vesh


3. Mësuesi do të kërkojë nga nxënësit që të thonë se çfarë ndryshimesh kanë ndodhur në këngën *Vrapimi* (kanë ndodhur ndryshime në shpejtësinë e ekzekutimit). Informon nxënësit se shpejtësia e ekzekutimit në muzikë quhet temp dhe i njej me shenjat dhe kuptimin e tyre.

4. Mësuesi do ta lëshojë incizimin e E. Grigut: *Në shpellën e mbretit të maleve*, kurse nga nxënësit do të kërkojë të dallojnë ndryshimet në shpejtësinë e ekzekutimit (kompozimi fillon ngadalë dhe pastaj rritet gradualisht dhe në fund bëhet shumë i shpejtë). Pas dëgjimit të dytë nxënësit duhet të vërejnë se me ndryshimet në shpejtësinë e ekzekutimit ndërrohet edhe dinamika (në fillim qetë, pastaj ngritet gradualisht dhe në fund bëhet e fortë). Para dëgjimit të tretë të muzikës, mësuesi do të shkruajë në tabelë emrin e kompozitorit dhe të veprës. Pas kësaj nxënësit dëgjojnë kompozimin e T. Albinonit *Adaxhio* dhe përshkruajnë vërejtjet e veta lidhur me të.

Pas dëgjimit të parë nxënësit duhet të caktojnë tempin (i ngadalshëm), dinamikën (qetë). Pas dëgjimit të dytë mësuesi informon nxënësit se instrumentet që dëgjohen në fillim të kompozimit quhen çembalo dhe organo. Në vazhdim të kompozimit nxënësit dallojnë instrumentet me hark. Mësuesi shkruan në tabelë emrin e kompozitorit dhe të veprës. Mësuesi do të bashkëbisedojë me nxënësit për kompozimet e dëgjuara për rolin që ka tempi në muzikë, gjegjësisht çfarë mund të shprehë me llojet e ndryshme të tempit. Hapin librin në faqen 10 dhe përgjigjen në pyetjet e rubrikës *Çfarë kemi mësuar*.

5. Në pjesën e mbylljes së orës mësuesi do të vendosë në tabelë ilustrimet e kafshëve të ndryshme (breshka, kali, gjarpri, lepuri, ketri). Do të kërkojë nga nxënësit që të dëgjojnë disa shembuj muzikorë me temp të ndryshëm p.sh. Sen Sans- *Antilopët*, *Akuariumi* ose ndonjë tjetër sipas zgjedhjes së mësuesit dhe të njohin se cili temp i përgjigjet shpejtësisë së lëvizjes së kafshëve nga ilustrimi. Gjithashtu nxënësit mund ta krahasojnë shpejtësinë e ecjes të një njeriu të mosuar, një fëmije, prindërve të vet dhe t'i imitojnë si edhe shfaqjeve të tjera nga jeta e përditshme.

Vërejtja e përgjithshme: Kudo ku janë parashikuar variantet e ekzekutimit për dëgjimin e muzikës: vokale apo vokalo-instrumentale, mësuesi duhet që t'i krahasojë dhe komentojë...



St. P. Korunoviq, *Miu dhe qumështi*

Qëllimi mësimor:

1. zgjerimi i njohurive për tempin
2. mësimi i lojës së re muzikore

Dëgjimi i muzikës:

1. St. P. Korunoviq, *Miu dhe qumështi*, ekzekutim vokalo-instrumental
2. St. P. Korunoviq, *Miu dhe qumështi*, ekzekutim instrumental

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse
2. mësimi i këngës *Miu dhe qumështi*, mësimi me vesh dhe njohja me nocionin ritardando
3. Mësimi i lojës muzikore dhe ekzekutimi i saj

1. Nxënësit këndojnë një këngë që e kanë mësuar para tempit dhe të përforcojnë njohuritë e fituara për llojet e tempit.

2. Të punohet kënga *Miu dhe qumështi* sipas procedimit metodik me vesh. Kur kënga të jetë e mësuar do të kërkojë nga nxënësit të vërejnë ndryshimet në shpejtësinë e ekzekutimit (këndimit). Nxënësit, duke kënduar këngën, kanë vërejtur se ngadalësimi shfaqet gradualisht. Mësuesi i informon nxënësit për shenjën e re ritardando, e cila shpreh ngadalësimin gradual dhe shënohet shkurt (rit). Kërkon nga nxënësit që të shikojnë tekstin me nota të këngës, ku në këtë tekst shkruhet kjo shenjë. Veç ndryshimeve në temp mësuesi u kërkon nxënësve të thonë se kanë ndodhur edhe ndryshimet dinamike.

3. Mësuesi do t'ua përshkruajë nxënësve lojën.
Përshkrimi i lojës: Nxënësit formojnë një rreth.

Teksti i lojës dhe ekzekutimi:

"Pa mendoni fëmijë..." - vendosin gishtat në ballë;
" Bishti në qumësht " – me gishtin tregues të dorës së djathtë tregojnë këmbën;
" E ai i mjeri " - me gishtin tregues të dorës së djathtë tregojnë djathtas e majtas;
" Dhe pothuaj gjith' e hëngri " - çojnë kokën prapa, ndërsa me dorën e djathtë tregojnë gojën;
" Duke menduar..." – kapen të gjithë përdore dhe shkojnë djathtas sipas ritmit;
".....sa i mirë " – ngadalësojnë, ndalen, hapin duart dhe tregojnë se riska e mishit është e mirë (ose tregojnë barkun,ose bëjnë ndonjë lëvizje sipas zgjedhjes së mësuesit).
Pas kësaj, me ndihmën e mësuesit, nxënësit ushtrojnë lojën muzikore.

Shkalla F-dur

Qëllimi mësimor:

1. arritja e njohurive për shkallën F-dur
2. mësimi i këngës së re

Dëgjimi i muzikës

1. St. P. Korunoviq, *Ariu Mishko*, ekzekutimi vokalo-instrumental
2. St. P. Korunoviq, *Ariu Mishko*, ekzekutimi instrumental
3. J. Hajden , *Simfonia e fëmijëve*

Hapat kryesorë:


1. pjesa hyrëse
2. punimi i këngës *Ariu Mishko*, sipas tekstit me nota
3. njohja me shkallën F-dur
4. dëgjimi analitik i muzikës

1. I bën nxënësit të këndojnë këngën *Solmizimi*. Përsërit njohuritë e fituara për shkallën muzikore dhe shpërndarjen e toneve dhe gjysmëtoneve në shkallën dur.

2. Punohet kënga "*Ariu Mishko*" sipas procedimit metodik të punimit të këngëve në tekstin me nota.

3. Duke shfrytëzuar shkrimin me nota në Tekstin mësimor të këngës "*Ariu Mishko*", nxënësit së pari do të bashkëbisedojnë për tekstin e këngës dhe pastaj me ndihmën e mësuesit do të analizojnë tekstin me nota. Mësuesi do të kërkojë nga nxënësit që në tekstin me nota, të dallojnë shenjën e re pas çelësit dhe do t'u sqarojë kuptimin e tij. Gjithashtu do të kërkojë nga nxënësit të dallojnë notën me të cilën kënga fillon dhe mbaron dhe duke ndjekur tekstin në libër të vijë deri tek përfundimi që kënga është shkruar mbi bazën e shkallës së re muzikore, F-dur. Do t'u kujtojë shpërndarjen e drejtë të gjysmëtoneve në shkallën dur dhe pastaj, duke shfrytëzuar ilustrimin e klaviaturës në Tekstin Mësimor, faqe 27 dhe njohin instrumentet në ilustrim.

4. Mësuesi do të bisedojë me nxënësit se çfarë mund të përshkruajë (shprehë) muzika (stinët vjetore, natyrën, dashurinë). Do të kërkojë nga nxënësit që të thonë se cilat janë ato mjete me të cilat shërbehet kompozitori për të shprehur fenomenin, stinët e vitit, ndjenjat, disponimin, (me ndihmën e ritmit, dinamikës, tempit, melodisë, instrumentit). Mësuesi do të lëshojë incizimin e kompozimit të J. Hajdenit *Simfonia e fëmijëve* dhe do të kërkojë të njohin ekzekutuesit (trumbetën, trianglin, daullen, bilbilin dhe "qyqen"). Do të kërkojë nga nxënësit të shohin Tekstin mësimor, faqe 27 dhe të njohin instrumentet në ilustrim.



Para çdo dëgjimi (aq herë sa u duhet fëmijëve të dallojnë karakteristikat) mësuesi do t'u japë nxënësve detyrë: të përcjellin me vëmendje në atë se si kompozitori e ka krijuar ritmin, melodinë (duke dhënë përgjigjet e mundshme dhe "sjelljen e "instrumenteve /grupeve instrumentale në shembullin e dëgjuar. Në fund, nxënësit duhet të shohin shkakun e krijimit të çdo komponenti muzikor në mënyrën e dhënë dhe si merr pjesë secili në pasqyrimin e karakterit të përgjithshëm të veprës muzikore. Në fund, figurën e plotë duhet ta lidhin me titullin e veprës.

Mësuesi do t'u thotë nxënësve se kanë dëgjuar kompozimin nga J. Hajden, i cili quhet *Simfonia e fëmijëve* dhe do të komentojë emërtimin e veprës.

Shkalla G-dur

Qëllimi mësimor:

1. arritja e njohurive për shkallën G-dur
2. mësimi i këngës së re

Dëgjimi i muzikës:

1. *Tani dimër më nuk ka*, ekzekutim vokalo-instrumental
2. *Tani dimër më nuk ka*, ekzekutim instrumental
3. M. Musorgski, *Loja e zogut në lëkurë të vezës*

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse
2. punimi i këngës "*Tani dimër më nuk ka*" sipas tekstit me nota
3. njohja me shkallën G-dur
4. dëgjimi analitik i muzikës

1. I bën nxënësit të këndojnë ndonjë këngë të njohur.

2. Punohet kënga "*Tani dimër më nuk ka*" sipas procedimit metodik të mëimit të këngës me tekstin me nota.

3. Duke shfrytëzuar shkrimin me nota të këngës "*Tani dimër më nuk ka*" në Tekstin mësimor, nxënësit së pari do të bisedojnë për tekstin letrar dhe pastaj me ndihmën e arsimtarit do të analizojnë tekstin me nota të këngës. Do të vërejnë se përsëri në tekstin me nota, pas çelësit do të kenë shenjën e re ngritëse). Mësuesi do t'ua sqarojë se ç'është ngritësja. Tek përfundimi se kënga e re është shkruar në shkallën e re muzikore, do t'i çojë duke u tërhequr vëmendjen në parashenjën e re dhe në notën me të cilën përfundon. Do t'u kujtojë shpërndarjen e drejtë të gjysmëtoneve në shkallën dur, ndërsa më vonë, duke shfrytëzuar ilustrimin e klaviaturës në Tekstin mësimor, faqe 29, do të kërkojë të vërejnë se përse grada e shtatë është rritur

4. Para dëgjimit të kompozimit, mësuesi do të kërkojë nga nxënësit që të shikojnë punimet në artin figurativ, të cilat ndodhen në klasë dhe të japin komentet e veta rreth tyre. Mësuesi do të informojë nxënësit se do të dëgjojnë pjesë nga një vepër më e madhe muzikore që quhet *Piktura të një ekspozite*. Njofton nxënësit si është krijuar kjo vepër. Mësuesi do të lëshojë incizimin e kompozimit, me detyrën që nxënësit të njohin ekzekutuesit (orkestrën). Para dëgjimit të dytë mësuesi do të kërkojë nga nxënësit të vërejnë dinamikën, tempin, melodinë dhe ritmin (duke u dhënë përgjigjet). Pas dëgjimit të tretë do të kërkojë që të thonë, nëse kjo melodi u kujton vallen-vallëzimin. Mësuesi do të informojë nxënësit se në këtë shembull shprehet vallëzimi dhe më qartë vallëzimi i zogjve të pulës që përpiqen të lirohen nga lëkura e vezës dhe të dalin në jetë. Mësuesi në këtë shembull mund t’u japë nxënësve që të “vizatojnë” muzikën me shenja grafike të ndryshme (linja, pika, viza) dhe në atë mënyrë të dallojnë që pjesa e parë dhe e tretë e kompozimit përsëriten. Kështu p.sh. do të kemi pikat në vizatimin e parë, në vizatimin e dytë linjat, ndërsa në të tretin përsëri pikat. Informon nxënësit për emërtimin e veprës së dëgjuar.

Prima dhe sekonda volta

Qëllimi mësimor:

1. arritja e njohurive për nocionet prima dhe sekonda volta
2. mësimi i këngës së re

Dëgjimi i muzikës:

1. B. Iliq, *Këndojmë*, ekzekutim vokalo-instrumental
2. B. Iliq, *Këndojmë*, ekzekutim instrumental
3. St. P. Korunoviq, *Ariu Mishko*, ekzekutimi vokalo-instrumental
4. St. P. Korunoviq, *Ariu Mishko*, ekzekutimi instrumental


Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse
2. punim i këngës *Këndojmë* sipas tekstit me nota
3. njohja me nocionin prima dhe sekonda volta
4. punim i këngës *Miu dhe qumështi* sipas tekstit me nota
5. pjesa përmblylëse

1. Në pjesën hyrëse të orës kërkohet nga nxënësit të dëgjojnë kompozimin *Meditimi*, ku kanë mësuar formën e re muzikore- periudhën. Përkujtojnë njohuritë e fituara për periudhën.

2. Të punohet kënga “*Këndojmë*” sipas procedimit metodik të mësimi të këngës sipas tekstit me nota.

3. Kur nxënësit ta kenë mësuar këngën *Këndojmë* të kërkohet nga ata të dallojnë në çfarë forme muzikore është shkruar. Kur ta njohin periudhën (duke kënduar këngën) të kërkohet prej



tyre që ta shikojnë me kujdes tekstin e notave të këngës pa shenjën prima e sekonda volta. Mësuesi i informon që këtë shembull mund ta shkruajnë më shkurt, ku përsëritja e pjesës së fjalisë së dytë të hiqej duke vendosur shenjën e përsëritjes. I informon për prima dhe sekonda voltën, për funksionin dhe kuptimin e tyre, në shembullin e këngës “Këndojmë”.

4. Kërkon nga nxënësit ta hapin librin në faqen 82 dhe të shikojnë tekstin me nota të këngës *Miu dhe qumështi*. Mësohet kënga *Miu dhe qumështi* sipas procedimit metodik të mësimin me tekstin me nota, ndërsa nxënësve u tërhiqet vëmendja në shenjat e prima dhe sekonda voltës.

5. Në pjesën e fundit të orës, nxënësit me ndihmën e mësuesit do të ushtrojnë këngët që kanë mësuar.

Vërejtje: Kënga *Miu dhe qumështi* përmban shenjat e prima dhe sekonda voltës (kjo këngë më parë është mësuar me vesh) dhe do të ishte mirë që në këtë orë të punohet me nota, sepse mësuesi ka kohë, meqë kënga *Këndojmë* është e shkurtër.

St. P. Korunoviq, *Dragoi*

Qëllimi mësimor:

1. përforcimi i njohurive të fituara për dinamikën dhe prima e sekonda voltën
2. zgjerimi i njohurive për tempin
3. mësimi i këngës së re

Dëgjim i muzikës:

1. S. P. Korunoviq, *Dragoi*, ekzekutim vokalo-instrumental
2. S. P. Korunoviq, *Dragoi*, ekzekutim instrumental

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse
2. punimi i këngës “*Dragoi*” me vesh dhe njohja me nocionin *accelerando*
3. mësimi i valles muzikore *Dragoi*

1. Nxënësit këndojnë këngën *Miu dhe qumështi* dhe përkujtojnë njohuritë e fituara për tempin.

2. Punohet kënga *Dragoi* sipas procedimit metodik të mësimin të këngës me vesh. Kur është mësuar kënga me vesh, të kërkojë nga nxënësit të dallojnë ndryshimet e tempit (shpejtimin dhe kthimin në tempin fillestar.) Kur nxënësit dallojnë se tempin shpejtohet gradualisht në një pjesë të këngës, mësuesi do t’i informojë për shenjën që vendoset në muzikë për shprehjen e atij ndryshimi (*accelerando*) dhe formën e saj të shkurtuar (*accel*) si mënyrë më e shpeshtë e shënimit të tij. Nxënësit gjithashtu duhet të dallojnë se pas shpejtimit, janë kthyer përsëri në tempin e mëparshëm. Mësuesi do të informojë nxënësit për mënyrën e shënimit të kësaj shfaqjeje (nocioni) (*a tempo*). Gjithashtu ai do të kërkojë nga nxënësit që në tekstin me nota të dallojnë shenjat e dinamikës, shenjat për prima dhe sekonda voltën dhe në atë mënyrë i vërtetojnë.

3. Mësuesi do t'ua përshkruajë vallen nxënësve.
Përshkrimi i valles: nxënësit rrinë në formë rrethi.

Teksti i valles dhe ekzekutimi:

"*Flutro flutro dragua*" - lënë duart mbi ballë dhe shikojnë lart, në largësi;

"*Në hapsirë larg*" - të dyja duart lart;

"*Era merr*" - lëvizin sipas ritmit djathtas dhe majtas dhe bëjnë me dorë;

"*Tremb të gjithë harabelat*" - qëndrojnë dhe tregojnë lart se si fluturojnë harabelat;

"*Xhiv, xhiv, xhiv*" - trokasin duart;

"*Ik në fushë*" - me duar në gjoks lëvizin kokën majtas djathtas me kanosje;

"*Flutro flutro dragua*" - (herën e parë) ngrejnë duart lart dhe ecin me hapa të shpejtë djathtas;

"*Flutro flutro dragua*" - (herën e dytë) ngrejnë përsëri duart lart, kthehen majtas dhe në fund përfundojnë këndimin duke ngadalësuar me duar të ngritura lart.

Vërejtje: Kjo valle mund të ekzekutohet edhe pa kënduar. Nxënësit atëherë do të shqiptonin tekstin vetëm duke respektuar shenjat e dinamikës, përshpejtimit dhe ngadalësimit.

Punimi i valles është menduar të jetë si përforsim i njohurive të fituara për dinamikën, tempin dhe sekonda voltën.

Pjesët e theksuara dhe të patheksuara të taktit

Qëllimi mësimor:

1. arritja e njohurive për pjesët e theksuara dhe të patheksuara të taktit

Dëgjimi i muzikës:

1. J. Shtraus, *Marshi i Radeckit*

2. J. Shtraus, *Në Danubin e bukur dhe të kalër*

3. A. Dvorzhak, *Vallja e parë sllave*

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse


2. dallimi i pjesëve të theksuara dhe të patheksuara të taktit përmes këngëve të numërimit dhe shembujve muzikorë

3. njohja me pjesët e theksuara dhe të patheksuara të taktit

4. zgjidhja e detyrave

5. dëgjimi analitik i muzikës

1. Në pjesën hyrëse të orës të bisedohet me nxënësit për theksin gjatë bisedës. Mësuesi do të shkruajë në tabelë fjalët: MA-MI, BA-BI, FLE-TO-RJA, LA-PSI, SHKE-NCA. Kërkon që me mësuesin t'i shqiptojnë këto fjalë. Nxënësit duhet të dallojnë se disa rrokje janë të theksuara..



2. U thotë nxënësve që të hapin Librin në faqen 39 dhe me ndihmën e mësuesit të mësojnë dy këngë numërimi. Mësuesi do të fusë nxënësit që në to të dallojnë lëvizjen e vendit të theksave dhe si ata ndikojnë në llojin e taktit.

Po të njëjtën gjë duhet të dallojnë edhe në shembujt muzikorë *Marshi i Radeckit* dhe në *Danubin e bukur dhe të kaltër*. Me këto shembuj nxënësit do të marshojnë, vallëzojnë, taktojnë... Në këtë mënyrë nxënësit duhet të mësojnë se edhe në muzikë, si edhe në bisedë, ekzistojnë ndërrimet e theksave: të theksuar dhe të patheksuar.

3. Mësuesi i njofton nxënësit se në muzikë ekzistojnë theksat metrikë, që kanë emërtimet dhe shenjat e tyre.

4. Mësuesi u jep nxënësve për të kryer detyrën nga Libri në faqen 40.

5. Në vazhdim të orës lëshon kompozimin e A. Dvorzhakut *Vallja e parë sllave*. Kërkon nga nxënësit që pas dëgjimit të parë të njohin ekzekutuesit (orkestrën). Përpara dëgjimit të dytë, nxënësit të komentojnë melodinë, ritmin, ndryshimet në dinamikë duke u ofruar përgjigje të mundshme. Tek dëgjimi i tretë mësuesi do të kërkojë nga nxënësit që në bazë të shembullit të dëgjuar të dallojnë theksat metrikë dhe të përcaktojnë llojin e masës (me ndihmën e taktimit). Mësuesi shkruan në tabelë emrin e autorit dhe emërtimin e veprës dhe informon nxënësit që A. Dvorzhak ka shkruar ciklin prej 16 *vallesh sllave*.

Masa 4/4

Qëllimi mësimor:

1. arritja e njohurive për llojin e ri të masës
2. mësimi i këngës së re

Dëgjim i muzikës:

1. M. Milanković- I. Stramaq, *Maestral*, versioni vokalo-instrumental
2. M. Milanković- I. Stramaq, *Maestral*, versioni instrumental

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse
2. njohja me masën 4/4
3. punimi i këngës *Maestral* sipas tekstit me nota
4. zgjidhja e detyrave

1. Në pjesën hyrëse, mësuesi do të kërkojë nga nxënësit që të taktojnë këngën e numërimit që është në masën 2/4 në Tekstin mësimor, faqe 40.

2. Mësuesi do të kërkojë nga nxënësit të shikojnë shkrimin e dytë të notave të të njëjtës këngë numërimi dhe të dallojë ndryshimet. Do të vërejnë se të dy këngët kanë të njëjtin ritëm, por janë të shkruara në lloje të ndryshme mase. Nxënësit përcjellin të njëjtin tekst në Tekstin Mësimor, ndërsa mësuesi ua sqaron llojin e ri të taktit (4/4), mënyrën e taktimit dhe shpërndarjen e theksave ritmikë.

3. Të punohet kënga *Maestral* sipas procedimit metodik për punimin e këngës sipas tekstit të notave. Në këngë të ushtrojnë taktimin në masën 4/4.

4. Me ndihmën e mësuesit, nxënësit zgjidhin detyrat e dhëna në Tekstin mësimor, faqe 42.

Nota katërshe me pikë

Qëllimi mësimor:

1. arritja e njohurive për zgjatjen e kohës së notës
2. mësimi i këngës së re

Dëgjim i muzikës:

1. J. Genov, *Pranvera*, versioni vokalo-instrumental
2. J. Genov, *Pranvera*, versioni instrumental
3. A. Vivaldi, *Pranvera*

Hapat kryesorë:


1. pjesa hyrëse
2. punimi me vesh i këngës *Pranvera*
3. njohja me notën katërshe me pikë
4. dëgjim analitik i muzikës
5. zgjidhja e detyrave

1. Në pjesën hyrëse nxënësit këndojnë një këngë të njohur.

2. Punohet kënga *Pranvera* sipas procedimit metodik për mësimin e këngës me vesh.

3. Kur nxënësit të mësojnë këngën, mësuesi do të kërkojë prej tyre që ta lexojnë këngën ritmikiisht duke taktuar dhe të ndjekin me kujdes kohën ritmike në fillim të këngës. Nxënësit duhet të vërejnë se në fillim të këngës ka një kohë ritmike të re. Mësuesi do të nxitë nxënësit që të shohin tekstin me nota të këngës dhe pastaj do t'u shpjegojë funksionin e pikës pranë vlerës së notës.

4. Mësuesi me nxënësit komenton se në ç'mënyrë kompozitori e ka pasqyruar pranverën. Pastaj lëshon incizimin *Pranvera* të A. Vivaldit me detyrën që në të të njohin ekzekutuesit.



Kur nxënësit të njohin instrumentalistët me hark, mësuesi para dëgjimit të dytë do të kërkojë të japin komentet e dinamikës, tempit e karakterit të kompozimit (duke u ofruar përgjigje të mundshme). Sipas asaj që kanë dëgjuar, nxënësit duhet të përfundojnë se fenomenet e natyrës (në këtë rast një stinë e vitit), përveç tekstit letrar mbi të cilin kompozohet melodia, në muzikë mund të shprehen vetëm me pjesmarrje të instrumenteve muzikore. Para dëgjimit të katërt, të kërkohet nga nxënësit të vizatojnë përjetimin e vet muzikor të veprës së dëgjuar.

5. Me ndihmën e mësuesit, nxënësit zgjedhin detyrat e dhëna në Tekstin mësimor, fq.43.

Nota gjashtëmbëdhjetëshe

Qëllimi mësimor:

1. arritja e njohurive për zgjatjen e re të kohës së notës
2. mësimi i këngës së re

Dëgjim i muzikës:

1. K.Babiq, *Ketri*, ekzekutimi vokalo-instrumental
2. K.Babiq, *Ketri*, ekzekutimi instrumental

Hapat kryesorë:

1. formimi i grupeve
2. punishta krijuese
3. punimi i këngës *Ketri* me vesh
4. njohja me notën gjashtëmbëdhjetëshe
5. zgjidhja e detyrave

Vërejtje: Për këtë orë mësuesi duhet të përgatisë më parë materialin në fletë letre. Në klasë të krijohet vendi ku do të qëndrojnë nxënësit në këmbë.

1. Të formohen katër grupe, ndërsa në secilin grup të jenë nga 5-6 nxënës.

2. Nxënësit vendosen në rreth sipas grupeve, ndërsa mësuesi qëndron në mes. Mësuesi do të tregojë fletët e përgatitura më parë, në të cilat ndodhen figura të kafshëve të ndryshme. Do të kërkojë prej tyre të thonë emrat e kafshëve në figura, duke i ndarë në rrokje. Pastaj do të caktojë që çdo grup të përfaqësojë një kafshë, figura e së cilës ndodhet në fletë. Ndërsa nxënësit thonë emrat e kafshëve në rrokje, duhet të imitojnë lëvizjet e atyre kafshëve (p.sh. luani tregon kanxhat; ariu lëkundet). Gjatë të folurit të nxënësve, mësuesi përcakton radhën e paraqitjes së grupeve dhe i ndihmon nxënësit të mbesin në të njëjtin temp. Kur nxënësit e kanë mësuar këtë pjesë, mësuesi do ta kthejë letrën nga ana tjetër, ku rrokjet janë shënuar “me pika” dhe numri i tyre i përgjigjet numrit të rrokjeve.

Që nga fillimi i lojës, mësuesi, gjatë shqiptimit të rrokjeve të fjalëve lëviz në vend duke dhënë tempin. Do të mbahet në figurën e ketrit, ku nxënësit do të kuptojnë që me një rrahje të dorës të shqiptojnë katër rrokjet e para dhe i bën të kuptojnë se kemi të bëjmë me një gjatësi të re të notës.

3. Mësuesi do të lexojë incizimin e këngës *Ketri* dhe e punon sipas procedimit metodik për punimin e këngës me vesh.

4. Mësuesi do të japë tekstin e notave në karton dhe do të kërkojë nga nxënësit të dallojnë vlerën e notës së re. Mësuesi shpjegon pamjen e notës së re dhe gjatësinë e saj.

5. Me ndihmën e mësuesit, nxënësit zgjidhin detyrat e dhëna në Tekstin mësimor, fq. 46.

K. Babiq, *Ketri*

Qëllimi mësimor:

1. zgjerimi i njohurive për notën gjashtëmbëdhjetëshe
2. zhvillimi i krijimtarisë muzikore të fëmijëve

Dëgjim i muzikës:

1. K. Babiq, *Ketri* - ekzekutim instrumental


Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse
2. punimi i këngës *Ketri* sipas tekstit me nota
3. ndarja në grupe dhe krijimi i melodisë në tekstin e dhënë

1. Nxënësit këndojnë këngën *Ketri*, e cila është mësuar në orën e kaluar, sipas mësimimit me vesh.

2. Punohet kënga *Ketri* sipas procedimit metodik për punimin me tekstin e notave. Mësuesi me nxënës përforcon njohuritë që kanë fituar për notën gjashtëmbëdhjetëshe.

3. Nxënësit ndahen në disa grupe. Çdo grupi i jepet teksti i këngës për fëmijë dhe disa instrumente nga grupi orfean i instrumenteve (triangli, raketaket, zilet etj.). Mësuesi do t'ua lexojë tekstin e këngës disa herë dhe do të theksojë me kujdes rrokjet që duhet. Informon nxënësit që gjatë kompozimit të kenë kujdes, që theksi në melodi t'i përgjigjet theksit në tekst. Nxënësit duhet ta dinë që tematikës së atij teksti i përgjigjen ritmi dhe melodia. Mësuesi të ndihmojë çdo grup për motivin fillestar, caktimin e llojit të tekstit duke u thënë se meqë e kemi motivin, duhet të mendojnë për të bërë zhvillimin dhe përfundimin, dhe pastaj ata vetë do ta vazhdojnë punën. Përfaqësuesi i grupit do ta paraqesë melodinë me nota. Kur të jetë mbaruar kënga,



nxënësitdo të ushtrojnë individualisht në kuadër të grupit të vet. Nxënësit që kanë marrë instrumente ritmike do të përfytyrojnë dhe përcjelljen ritmike për melodinë që kanë kompozuar. Nxënësit që kanë instrumentet melodike ekzekutojnë melodinë që kanë kompozuar. Nxënësit sipas grupeve do të ekzekutojnë meloditë, ndërsa mësuesi do t'i përcjellë në piano.

Teksti i propozuar për këngën *Shkon patani*

Shkon, shkon patani në rrugë larg
Bishti është' i shkurtër, sqepi i tij i verdhë
Si një ushtar duket tra-ta, tra-ta, ta,
Shkon që të lahet: kva-va, kva-va, kva.

Vërejtje: Mësuesi mund ta zgjedhë edhe vetë tekstin në të cilin nxënësit mund të kompozojnë melodinë.

Nëse në kabinet ka kushte, meloditë e nxënësve të incizohen, të dëgjohen dhe bashkë me nxënësit të votohet për të zgjedhur më të mirën.

Muzika popullore në Malin e Zi

Qëllimi mësimor:

1. fitimi i njohurive për muzikën popullore malazeze

Dëgjimi i muzikës:

1. *Ra dëbora në lule, në pemë*
2. *Mali i Zi nënë e dashur*
3. *Në Zotëri Ivanin*
4. *Buron uji i burimit*
5. *Shkoi Mara të vëjë kurorë*
6. *Këta të dy breth e pishë*
7. *Kërshëndellat shkojnë rrugës dhe gëzohen*
8. *Bojana ruan delet*
9. *Gjurmët nuk t'i di, dukjen s'ta dëgjoj*
10. *Vallja e Zetës*
11. *Vallja e Shkalarit*
12. *Vallja e vajzave të Gucisë*

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse
2. njohja me këngët dhe vallet popullore malazeze
3. formimi i grupeve
4. raportimi i grupeve

1. Në pjesën hyrëse të orës, mësuesi lëshon incizimin e këngës së njohur popullore malazeze të mësuar që në klasën e katërt *Ra dëbora në lule, në pemë*. Kur nxënësit ta dëgjojnë, në bazë të njohurive të fituara më parë, do të fillojnë bisedën për muzikën popullore malazeze.

Mësuesi do të bisedojë me nxënësit për krijimin e tregimeve, poezive, muzikës popullore (nuk kanë autor, kalojnë brez pas brezi, çdo version është deri diku i ndryshëm).

2. Mësuesi do të lëshojë këngët e dhëna të *Dëgjimi i muzikës*(3,4,5,6,7,8,9). Me nxënësit do të bëjë bisedë për tematikën e këngëve, mënyrën e ekzekutimit, për pjesëmarrësit në ekzekutim dhe pastaj do të definojë këngët sipas llojeve, sqaron mënyrën dhe rastin në të cilat këndohen, kush i ekzekuton etj.

Duke lëshuar incizimin me zë të *Valles së Zetës* nxënësit kujtohen në vallet popullore malazeze që kanë mësuar deri tani dhe diskutojnë rreth tyre. Pastaj dëgjojnë edhe valle të tjera malazeze që njohin si *Valle e Crmnicës*, *Valle e Gucisë*, *Valle e Shkalarit* dhe sipas mundësive të shikohen edhe në DVD. Mësuesi do të bisedojë me nxënësit mbi mënyrën e kërcimit të tyre, valltarëve, rasteve kur ato ekzekutohen, duke i lidhur me territorin ku ato zhvillohen dhe nga i cili kanë marrë edhe emrin.

3. Pastaj mësuesi do të ndajë nxënësit në shumë grupe. Detyrë e të gjithë nxënësve të grupeve është që në bazë të muzikës së dëgjuar, informacioneve nga Teksti mësimor, të japin karakteristikat kryesore të këngëve dhe valleve popullore malazeze:

Grupi i parë do të thotë llojet e këngëve popullore malazeze që këndohen dhe si këndohen;

Grupi i dytë duhet të thotë vallet popullore malazeze, si dhe në ç'raste ekzekutohen;


Grupi i tretë duhet të cekë dallimin në veshje tek vallet popullore malazeze dhe të përcaktojë se në cilën anë të Malit të Zi e kanë origjinën;

Grupi i katërt duhet të krahasojë melodinë dhe hapat e valleve të ndryshme popullore malazeze;

Grupi i pestë duhet të krahasojë pjesëmarrësit në ekzekutimin e valleve popullore malazeze dhe të vërejë dallimet mes tyre.

4. Pas punës me grup, përfaqësuesi i çdo grupi njofton për detyrën që u është dhënë, ndërsa nxënësit e grupeve të tjera përcjellin dhe marrin pjesë duke u bërë pyetje ose duke plotësuar përgjigjet e dhëna.

Vërejtje: Për arsye të përbërjes, porosisim që kjo njësi mësimore të zhvillohet në dy orë.



Instrumentet popullore

Qëllimi mësimor:

1. fitimi i njohurive për tingullin dhe ndërtimin e instrumenteve muzikore në truallin e Malit të Zi

Dëgjimi i muzikës:

1. *Mal i Zi, nënë e dashur* - lahutë
2. *O agim i ndritur i majit* - zumarë
3. *Slobodaan Tërkula, Vallja që ecën* - fyell

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse
2. njohja me tingullin dhe ndërtimin e lahutës, zumarëve dhe fyellit
3. formimi i grupeve
4. raportimet e grupeve

1. Në pjesën hyrëse të orës, mësuesi bashkë me nxënësit do të kujtojnë karakteristikat kryesore të muzikës popullore malazeze. Nxënësit dëgjojnë këngën e njohur me lahutë *Mal i Zi, nënë e dashur* dhe mësuesi kërkon që ta njohin dhe të thonë se cilit lloj i takon (epik).

2. Duke dëgjuar këngën, nxënësit duhet të dallojnë instrumentin me të cilin këndohet (lahutë). Atëherë mësuesi duhet t'u tregojë nxënësve fotografinë e lahutës në Tekstin mësimor dhe të bisedojë me ta për pjesët dhe ndërtimin e instrumentit, mënyra si fitohet tingulli dhe rastet në të cilat përdoret. Në të njëjtën mënyrë, në bazë të shembujve të dhënë për dëgjim (në Manual dhe në Tekstin mësimor) punohen instrumentet e tjera popullore në truallin e Malit të Zi, zumarja e fyelli.

3. Pastaj mësuesi do të ndajë nxënësit në shumë grupe. Detyra e nxënësve të të gjitha grupeve është që në bazë të muzikës së dëgjuar, fotografive, informacioneve nga Teksti të japin karakteristikat kryesore të instrumenteve popullore në truallin e Malit të Zi:

Grupi i parë do të thotë se në cilat krahina të Malit të Zi përdoren këto instrumente;

Grupi i dytë duhet të përshkruajë pamjen dhe ndërtimin e të tri instrumenteve;

Grupi i tretë ka për detyrë të krahasojë zërin e këtyre tri instrumenteve;

Grupi i katërt duhet të thotë si përdoren këto instrumente (me instrumente të tjera, vetëm, si shoqërues të këngës ose valles etj.).

4. Pas punës me grup, përfaqësuesi i çdo grupi njofton për detyrën që u është ngarkuar, ndërsa nxënësit e grupeve të tjera ndjekin dhe marrin pjesë duke bërë pyetje ose duke plotësuar përgjigjet e dhëna.

Këta të dy si bre dh e pishë, këngë popullore nga Mali i Zi (Vallja e Zetës)

Qëllimi mësimor:

1. mësimi i këngës së re
2. mësimi i valles së re popullore

Dëgjim i muzikës:

1. *Vallja e Zetës* - ekzekutim vokalo-instrumental
2. *Këta të dy si bre dh e pishë* - ekzekutim vokalo-instrumental

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse
2. punimi i këngës *Këta të dy si bre dh e pishë*, sipas tekstit me nota
3. fitimi i njohurive për muzikën e pjesës qendrore të Malit të Zi
4. mësimi i hapave të valles popullore dhe ekzekutimi i saj

1. Në pjesën hyrëse të orës, mësuesi nga CD-ja do të lëshojë incizimin e *Valle, valle kapemi* dhe u kujton nxënësve njohuritë e fituara për muzikën popullore në folklorin muzikor malazez.

2. Punohet kënga *Këta të dy si bre dh e pishë* sipas procedimit metodik të mësimimit me vesh.

3. Në bazë të tekstit dhe të melodisë së këngës, nxënësit duhet të arrijnë në përfundimin se kënga është nga pjesa qendrore e Malit të Zi.


Pas kësaj, mësuesi do të informojë nxënësit se në këtë orë do të punojë këngën nga viset qendrore të Malit të Zi. Mësuesi do të informojë nxënësit për karakteristikat e folklorit të kësaj krahine, varësinë e kushtëzuar nga rrethanat gjeografike dhe historike, për traditat, veshjen, muzikën, ndërtimtarinë etj. Bisedën e shoqëron me fotografi nga Teksti mësimor dhe i komenton ato. Kërkon nga nxënësit që të thonë qytetet në pjesën qendrore të Malit të Zi dhe të vërejnë pjesën e hijezuar të hartës në Tekstin mësimor që tregon këtë hapësirë.

4. Kur kënga të jetë mësuar, të vazhdohet mësimi i hapave të valles. Mësuesi do të njoftojë nxënësit se është fjala për **këngën me valle**, shumë tipike për folklorin malazez dhe që kërcëhet në çift. Nxënësit do të rrinë në rreth, ndërsa brenda tij, dy nga dy (vajzë dhe djalë) mësojnë hapat e lojës derisa të tjerët vëzhgojnë..

Përshkrimi i valles:

Takti i parë:

Koha e parë- dy hapa me kërcimin djathtas me këmbën e djathtë të kthyer kryq mbi të majtën



Koha e dytë – dy hapa me kërcimin djathtas me këmbën e djathtë të kthyer kryq mbi të majtën

Pjesa tjetër njësoj si në taktin e parë.

Takti i dytë:

Koha e parë – dy kërcime majtas me këmbën e majtë kryq mbi të djathtën

Koha e dytë - dy kërcime majtas me këmbën e majtë kryq mbi të djathtën

Takti i tretë të luhet si i pari.

Takti i katërt të luhet si i dyti.

Derisa lozin, djemtë mbajnë duart të hapura përmbi krahët, ndërsa vajzat, gjysmë të hapura nën lartësinë e krahut. Qëndrojnë njëri përballë tjetrit.

Nxënësit e realizojnë vallen me këngë nën shoqërimin e CD-së. Pas kësaj nxënësit e ekzekutojnë vallen në çifte në mënyrë alternative, derisa të tjerët i përcjellin duke kënduar.

Vërejtje: Për realizimin e kësaj ore është e domosdoshme që të përgatitet klasa për ekzekutimin e kësaj valleje ose, nëse në shkallë ka sallë më të madhe.

Mirë se erdhët, dasmorë të stolisur, këngë popullore nga Mali i Zi (Cetinjë)

Qëllimi mësimor:

1. mësimi i këngës së re

Dëgjim i muzikës:

1. *Mirë se erdhët dasmorë të stolisur* - ekzekutim vokalo-instrumental
2. *Mirë se erdhët dasmorë të stolisur* - ekzekutim instrumental

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse
2. punimi i këngës *Mirë se erdhët dasmorë të stolisur* - sipas tekstit me nota
3. bisedë rreth territorit nga rrjedh kjo këngë
4. pjesa përfundimtare

1. Ora fillon me përsëritjen e këngës së njohur popullore *Këta të dy si breth e pishë*.

2. Punohet kënga *Mirë se erdhët, dasmorë të stolisur* sipas procedimit metodik për punimin me tekstin me nota.

3. Kur të jetë mësuar kënga, duhet të njoftohen nxënësit se kënga rrjedh nga rrethinat e Cetinjës. Të kërkojë nga nxënësit të thonë çfarë dinë për këtë qytet (pozicioni gjeografik, kryeqytet i Malit të Zi, vendlindja e Njegoshit etj) dhe të thonë pozicionin e qytetit në hartën e Malit të Zi.

4. Kur kënga të jetë e punuar me nota, të dëgjohet ekzekutimi vokalo-instrumental nga CD-ja. Detyra e nxënësve është të dallojnë instrumentet popullore me të cilat ekzekutohet.

O dritare, o helmi im i hidhur, këngë popullore nga Mali i Zi (Plevlë)

Qëllimi mësimor:

1. mësimi i këngës së re
2. modelimi i shoqërimit ritmik

Dëgjim i muzikës:

1. *O dritare, o helmi im i hidhur* - ekzekutim vokalo-instrumental
2. *O dritare, o helmi im i hidhur* - ekzekutim instrumental

Hapat kryesorë:


1. pjesa hyrëse
2. punimi i këngës *O dritare, o helmi im i hidhur* - sipas mëimit me vesh
3. bisedë rreth territorit nga rrjedh kjo këngë
4. formimi i grupeve për modelimin e shoqërimit ritmik

1. Ora duhet filluar me një këngë ose valle nga pjesa veriore e Malit të Zi, me të cilën nxënësit janë njohur në klasat e mëparshme (sipas zgjidhjes së mësuesit).

2. Punohet kënga *O dritare, o helmi im i hidhur* sipas procedimit metodik me të dëgjuar.

3. Në bazë të tekstit dhe melodisë së këngës, mësuesi do të kërkojë nga nxënësit që të konkludojnë se kënga është nga pjesa veriore e Malit të Zi. Do t'i njohë me karakteristikat e folklorit të kësaj krahine, të kushtëzuar nga pozicioni gjeografik dhe rrethanat historike, traditat, veshjet, muzika, ndërtimtaria etj. Biseda të shoqërohet me fotografi nga Teksti mësimor dhe bëhet komentimi i tyre. Të kërkojë nga nxënësit të thonë qytetet e pjesës veriore të Malit të Zi dhe të vërejnë pjesën e hijezuar në hartën e Malit të Zi që ndodhet në këtë Tekst mësimor dhe që e tregojnë këtë hapësirë.

4. Kur kënga të jetë mësuar, mësuesi duhet t'i ndajë nxënësit në grupe dhe të kërkojë prej tyre që vetë ata të modelojnë përcjelljen ritmike duke përdorur ato lloje instrumentesh që ka shkolla në dispozicion (raketake, dajre, kastanjet, daulle). Grupet do të punojnë njëkohësisht në përvetësimin e detyrave të dhëna, ndërsa mësuesi do t'i mbikëqyrë dhe sipas nevojës do t'u ndihmojë.



Kur grupet të ushtrojnë pjesët, së pari do t'i ekzekutojnë individualisht. Pas kësaj mësuesi do t'i bashkojë grupet njëra me tjetrën dhe pastaj të gjitha grupet së bashku do ta ekzekutojnë bashkarisht.

Tre beqarë ecin rrugës, këngë popullore nga Mali i Zi (Berane)

Qëllimi mësimor:

1. mësimi i këngës së re

Dëgjim i muzikës:

1. *Tre beqarë ecin rrugës* - versioni vokalo-instrumental
2. *Tre beqarë ecin rrugës* – ekzekutojnë këngëtarë të muzikës popullore

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse
2. punimi i këngës *Tre beqarë ecin rrugës* - sipas tekstit me nota
3. pjesa përfundimtare

1. Në pjesën hyrëse të orës përsëritet kënga *O dritare, o helmi im i hidhur* dhe u thuhet nxënësve karakteristikat e muzikës popullore në pjesën veriore të Malit të Zi.

2. Punohet kënga *Tre beqarë ecin rrugës* sipas procedimit metodik të mëimit të këngës me tekstin me nota.

3. Në pjesën përfundimtare të dëgjohet ekzekutimi i këngës nga CD-ja nën interpretimin e këngëtarëve të muzikës popullore që nxënësit të fitojnë gjithë përshtypjen tingullore nga ekzekutimi burimor.

Vërejtje: Kënga të mësohet pas punimit të notës katërshe me pikë.

Smilaniq, të janë lagur puplat, këngë popullore nga Mali i Zi (Përçanj)

Qëllimi mësimor:

1. mësimi i këngës së re
2. mësimi i ujdijes instrumentale

Dëgjim i muzikës:

1. *Smilaniq, të janë lagur puplat* - ekzekutimi vokalo-instrumental
2. *Smilaniq, të janë lagur puplat* – ekzekutimi instrumental

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse
2. punimi i këngës *Smilaniq, të janë lagur puplat* - sipas mësimet me vesh
3. bisedë për krahinën nga rrjedh kjo këngë
4. formimi i grupeve për përvetësimin e pjesëve të rregulluara
5. këndimi i këngës me rregullimin instrumental


1. Në pjesën hyrëse të orës, nxënësit të këndojnë ndonjë këngë të njohur nga Bregdeti, (sipas zgjidhjes së mësuesit).

2. Të punohet kënga *Smilaniq, të janë lagur puplat* sipas procedimit metodik të të mësuarit me vesh.

3. Në bazë të tekstit dhe të melodisë, mësuesi do të kërkojë nga nxënësit që të konkludojnë se kënga është nga pjesa bregdetare e Malit të Zi. Do t'i njohë me karakteristikat e folklorit të kësaj hapësire, kushtet e pozicionit gjeografik dhe rrethanat historike, traditat, veshjen, muzikën, ndërtimtarinë etj. Biseda të shoqërohet me fotografi nga Teksti mësimor dhe të komentohen. Kërkon nga nxënësit të thonë qytetet bregdetare të Malit të Zi dhe t'i shohin në hartën e dhënë në Tekstin mësimor, në pjesën e hijezuar që përmbledh këtë hapësirë.

4. Për t'iu qasur mësimet të rregullimit (aranzhmanit) Teksti mësimor faqe 94, mësuesi do t'i ndajë nxënësit në tri grupe të cilat do ta ekzekutojnë këngën me instrumentet e shënuara në Tekstin mësimor (nëse shkolla nuk i ka këto instrumente të shfrytëzohen të tjerat nga instrumentet Orfeane). Grupi i parë do të duhej të përvetësonte pjesën e shkruar për bllok flautin, e dyta për raketaket, e treta për dajren. Grupet do të punojnë njëherësh në përvetësimin e detyrave të dhëna, ndërsa mësuesi do t'i mbikëqyrë dhe ndihmojë sipas nevojës.

5. Kur grupet të ushtrojnë pjesët, së pari duhen ndarë një nga një. Pas kësaj, mësuesi do të bashkojë grupet njera me tjetrën në mënyrë të alternuar dhe pastaj të gjitha grupet ekzekutojnë së bashku.



Fryn lehtë, këngë popullore nga Mali i Zi (Boka e Kotorit)

Qëllimi mësimor:

1. mësimi i këngës së re

Dëgjim i muzikës:

1. *Fryn lehtë* - ekzekutimi vokalo-instrumental
2. *Fryn lehtë* – ekzekutimi instrumental

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse
 2. punimi i këngës *Fryn lehtë* - sipas tekstit me nota
 3. pjesa përfundimtare
1. Ora të fillojë me ndonjë këngë të njohur nga Bregdeti (sipas zgjedhjes së mësuesit).
 2. Punohet kënga *Fryn lehtë* sipas procesit metodik të mësimin të këngës me tekstin me nota.
 3. Në fund të orës të dëgjohet kënga nga CD-ja nën ekzekutimin e grupit, që nxënësit të krijojnë përshtypjen e përgjithshme të tingëllimit nga ekzekutimi burimor.

Prashit vajza në vresht, këngë popullore nga Serbia

Qëllimi mësimor:

1. mësimi i këngës së re
2. fitimi i njohurive për muzikën popullore serbe

Dëgjim i muzikës:

1. *Prashit vajza në një vresht* - ekzekutimi vokalo-instrumental
2. *Prashit vajza në një vresht* – ekzekutimi instrumental
3. *Ku ke qenë keci im*, nën ekzekutimin e Svetllana Spajiqit
4. *Krisi pushka në malin e gjelbër*, në ekzekutim të Bilana Kërstiqit
5. *Pse Morava rrjedh e turbullt*, ekzekuton grupi *Drina*.
6. *Çoçek*- në ekzekutimin e orkestrës së Boban Markoviqit

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse
2. punimi i këngës *Prashit vajza në një vresht* - sipas mësimit të tekstit me nota
3. njohja me shenjat e muzikës popullore serbe
4. pjesa përfundimtare

1. Ora të fillojë me ndonjë këngë popullore nga Serbia, me të cilën nxënësit janë njohur në klasat e mëparshme (sipas zgjidhjes së mësuesit).

2. Punohet kënga *Prashit vajza në një vresht* sipas procedimit mësimor të tekstit me nota.

3. Nxënësit do të vërejnë se është fjala për një këngë serbe.

Udhëzon nxënësit që në hartën në Tekstin mësimor faqe 74, të dallojnë pozitën e Serbisë dhe ta komentojnë në lidhje me Malin e Zi. Pyet nxënësit se çfarë dinë për atë vend fqinj.

Pastaj mësuesi do të informojë nxënësit mbi karakteristikat kryesore të muzikës popullore të atij vendi, instrumentet popullore, këngët dhe vallet. Bisedën ta shoqërojë me shembujt muzikorë të dhënë nën *Dëgjimi i muzikës* (3, 4, 5, 6) si dhe fotografitë që ndodhen në faqen 75 të Tekstit mësimor.

4. Të dëgjohet nga CD-ja ekzekutimi vokalo-instrumental i këngës, që nxënësit të fitojnë përshtypjen e përgjithshme të ekzekutimit burimor dhe t'i informojë që kënga rrjedh nga Sremi.

Gjura Jakshiq, *Mes natës së heshtur dhe degëve të shpeshta*, këngë e vjetër qytetare nga Serbia.

Qëllimi mësimor:


1. mësimi i këngës dyzërëshe me vesh

Dëgjim i muzikës:

1. *Prashit vajza në një vresht* - ekzekutimi instrumental
2. Gj. Jakshiq: *Mes natës së heshtur dhe degëve të shpeshta* – ekzekutimi vokalo-instrumental
3. Gj. Jakshiq: *Mes natës së heshtur dhe degëve të shpeshta* – ekzekutimi instrumental

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse
2. formimi i grupeve dhe punimi i këngës me vesh
3. bashkimi i pjesëve të mësuara
4. ekzekutimi vokalo-instrumental i këngës



1. Ora të fillojë me përsëritjen e këngës popullore nga Serbia p.sh. *Prashit vajza në një vresht*.

2. Mësuesi do të ndajë nxënësit në dy grupe dhe pastaj do të punojë këngën *Mes natës së heshtur dhe degëve të shpeshta* sipas procedimit metodik për punimin e këngës me vesh. Me grupin e parë mësuesi punon për punimin e zërit të lartë, ndërsa me të dytën, me zërin e ulët.

3. Kur çdo zë të ketë mësuar melodinë e vet, mësuesi do t'i bashkojë.

4. Pas kësaj, nxënësit do të ekzekutojnë dyzërëshin e mësuar me shoqërimin instrumental nga CD-ja dhe do të dëgjojnë ekzekutimin vokalo-instrumental të këngës nga CD-ja.

Vërejtje: Për arësye të përbërjes së këngës (dyzërëshe) mësuesi duhet të planifikojë punimin në dy orë.

Nën manaferrë, këngë popullore nga Kroacia (Megjimurje)

Qëllimi mësimor:

1. mësimi i këngës dyzërëshe me vesh
2. mësimi i rregullimit instrumental

Dëgjim i muzikës:

1. *Nën manaferrë* - ekzekutimi vokalo-instrumental
2. *Nën manaferrë* – ekzekutimi instrumental
3. *Beqari i Sllavonisë*- ekzekutim i Krunosllav - Kiqe Sllabinac
4. *Kur tingëllojnë këmbanat*, në interpretim të Ante Bushiqit
5. O. Dragojeviq: *Pulëbardha dhe unë*, në interpretim të *Tragos*
6. *I pasuri i lumtur*, nën ekzekutimin e grupit *Neverin*

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse
2. mësimi i këngës *Nën manaferrë* sipas mësimimit me vesh
3. njohja me karakteristikat e muzikës popullore kroate
4. ekzekutimi vokalo-instrumental i këngës

1. Në pjesën hyrëse të orës nxënësit të këndojnë një këngë të njohur popullore kroate me të cilën janë njohur në klasat e mëparshme (sipas zgjedhjes së mësuesit).

2. Të punohet kënga *Nën manaferrë* sipas procedimit metodik të të mësuarit me vesh.

3. Pastaj të shikohet në hartën në Tekstin mësimor, faqe 77, pozita e Kroacisë dhe të komentohet pozicioni i saj në lidhje me Malin e Zi. Pyeten nxënësit çfarë dinë për këtë

vend fqinj. Pas kësaj mësuesi do të informojë nxënësit për karakteristikat kryesore të muzikës popullore të këtij vendi, instrumenteve popullore, këngëve dhe valleve. Biseda të shoqërohet me shembujt muzikorë të dhënë nën rubrikën *Dëgjimi i muzikës* (3, 4, 5, 6) dhe fotografive që ndodhen në Tekstin mësimor në faqe 77. I informon ata që kënga *Nën manaferrë*, që e kanë mësuar rrjedh nga krahina e Kroacisë që quhet Megjimurje.

4. Pastaj mësuesi do t'i ndajë nxënësit në tri grupe. Ata do të ushtrjnë secili për vete pjesët e veta në instrumentet e shënuara në Tekstin mësimor, faqe 94.

Grupi i parë do të ushtrjë pjesën e shkruar për metalofon, e dyta për raketaket, e treta për shkopinjët. Ndërsa grupet punojnë për kryerjen e detyrave të dhëna, mësuesi i mbikëqyrë dhe i ndihmon në rast nevojë.

5. Kur grupet të ushtrjnë pjesët, së pari do t'i ekzekutojnë një nga një. Pastaj mësuesi do të bashkojë grupet njëri me tjetrin dhe pastaj të gjitha grupet ekzekutojnë së bashku.

Si vjen devri, vjen zamani, këngë popullore nga Shqipëria

Qëllimi mësimor:

1. mësimi i këngës së re
2. fitim i njohurive për muzikën popullore shqiptare

Dëgjim i muzikës:


1. *Si vjen devri, vjen zamani* - ekzekutimi vokalo-instrumental
2. *Si vjen devri, vjen zamani* - ekzekutimi instrumental
3. *Hipi cuca në majë të gurit*- këngë popullore
4. *Potpuri vallesh të veriut*- valle popullore shqiptare
5. *Melodi me çifteli*

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse
2. formimi i grupeve dhe mësimi i këngës *Si vjen devri, vjen zamani*, me vesh
3. njohja me karakteristikat e muzikës popullore shqiptare
4. pjesa përfundimtare

1. Në pjesën hyrëse të orës, nxënësit të këndojnë një këngë të njohur popullore shqiptare me të cilën janë njohur në klasat e mëparshme (sipas zgjedhjes së mësuesit).

2. Mësuesi do t'i ndajë nxënësit në dy grupe dhe pastaj do të punojë këngën *Si vjen devri, vjen zamani*, sipas procedimit metodik të të mësuarit me vesh. Me grupin e parë mësuesi do të punojë për aftësimin në zërin e lartë, ndërsa me grupin e dytë në aftësimin (përvetësimin) e zërit të ulët.



3. Pastaj shikohet në hartën në Tekstin mësimor, faqe 79, pozita e Shqipërisë dhe komentohet pozicioni i saj në lidhje me Malin e Zi. Pyeten nxënësit se çfarë dinë për atë vend fqinj. Pas kësaj mësuesi do të informojë nxënësit mbi karakteristikat kryesore të muzikës popullore të këtij vendi, instrumenteve popullore dhe këngëve e valleve. Biseda të shoqërohet me shembujt muzikorë të vënë në rubrikën *Dëgjimi i muzikës* (nr. 3, 4, 5) dhe fotografive që ndodhen në Tekstin mësimor, faqe 79.

4. Në fund të orës së mësimi të këndohet kënga me ekzekutimin instrumental nga CD-ja.

Pranvera në pyll, këngë nga Finlanda

Qëllimi mësimor:

1. mësimi i këngës së re
2. mësimi i rregullimit instrumental

Dëgjim i muzikës:

1. *Pranvera në pyll*- ekzekutimi vokalo-instrumental
2. *Pranvera në pyll* - ekzekutimi instrumental

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse
2. punimi i këngës *Pranvera në pyll* sipas procedimit metodik me tekstin me nota
3. formimi i grupeve dhe mësimi i pjesëve aranzhuara
4. ekzekutimi vokalo-instrumental i këngës

1. Në pjesën hyrëse të orës nxënësit të këndojnë një këngë të njohur popullore ose ndonjë model melodie.

2. Të punohet kënga *Pranvera në pyll* sipas procedimit metodik me tekstin me nota.

3. Pastaj mësuesi do t'i ndajë nxënësit në tri grupe. Secili prej tyre do të ushtrojë për vete pjesët e veta në instrumentet e shënuara në Tekstin mësimor, faqe 93.

4. Grupi i parë do të ushtrojë pjesën e shkruar për metalofon, i dyti të shkruar për raketa- ket, i treti për shkopinjtë. Derisa grupet punojnë për kryerjen e detyrave të dhëna, mësuesi i mbikëqyrë dhe i ndihmon sipas nevojës.

5. Kur grupet ushtrojnë në pjesët e dhëna, së pari duhet t'i ekzekutojnë ato një e nga një. Pas kësaj mësuesi do të bashkojë grupet në mënyrë alternative njëri me tjetrin dhe pastaj të gjitha grupet ekzekutojnë së bashku.

R. Zverko-A. Kabilo, *Të qeshurit nuk është mëkat*

Qëllimi mësimor:

1. mësimi i këngës së re
2. modelimi i shoqërimit ritmik

Dëgjim i muzikës:

1. R. Zverko-A. Kabilo, *Të qeshurit nuk është mëkat*, ekzekutimi vokalo-instrumental
2. R. Zverko-A. Kabilo, *Të qeshurit nuk është mëkat*, ekzekutimi instrumental

Hapat kryesorë:


1. pjesa hyrëse
2. punimi i këngës *Të qeshurit nuk është mëkat* sipas procedimit metodik me vesh
3. formimi i grupeve dhe modelimi i shoqërimit ritmik
4. ekzekutimi vokalo-instrumental

1. Në pjesën hyrëse të orës nxënësit të këndojnë një këngë të njohur (sipas zgjedhjes së mësuesit).

2. Pastaj punohet kënga *Të qeshurit nuk është mëkat* sipas procedimit metodik me vesh.

3. Kur kënga të jetë mësuar, nxënësit të ndahen në disa grupe me synimin që secili prej tyre të bëjnë shoqërimin ritmik në goditëset, të cilat shkolla i ka në dispozicion (daullet, triangli, raketake, dajre, kastanjeta).

4. Kur grupet të ushtrjnë pjesët e caktuara, së pari duhet t'i ekzekutojnë një nga një. Pastaj mësuesi do t'i bashkojë grupet në mënyrë alternative njëri me tjetrin dhe më vonë të gjitha grupet e ekzekutojnë aranzhmanin së bashku.



S. Raiçiq- Xhaxhi Androja, *Brumbujt dhe bletët*

Qëllimi mësimor:

1. mësimi i këngës së re

Dëgjim i muzikës:

1. S. Raiçiq - Xhaxhi Androja, *Brumbujt dhe bletët*, ekzekutimi vokalo-instrumental
2. S. Raiçiq - Xhaxhi Androja, *Brumbujt dhe bletët*, ekzekutimi instrumental

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse
2. punimi i këngës *Brumbujt dhe bletët*, sipas procedimit metodik me vesh
3. bashkimi i pjesëve të mësuara
4. ekzekutimi vokalo-instrumental i këngës

1. Ora duhet të fillojë me përsëritjen e ndonjeres nga këngët dyzërëshe të punuara më parë, e cila do të shërbente për t'u kënduar.

2. Mësuesi do t'i ndajë nxënësit në dy grupe dhe pastaj do të punojë këngën *Brumbujt dhe bletët* sipas procedimit metodik të mësuarit me vesh. Me grupin e parë mësuesi do të punojë për aftësimin në zërin e lartë (sipërm), ndërsa me të dytën në zërin e ulët (poshtëm).

3. Kur secili zë të përvetësojë melodinë e vet, mësuesi do t'i bashkojë.

4. Pas kësaj, nxënësit do të ekzekutojnë dyzërëshin e mësuar me shoqërim instrumental me CD dhe do të dëgjojnë ekzekutimin vokalo-instrumental të këngës nga CD-ja.

Në shkronjë, këngë nga Anglia

Qëllimi mësimor:

1. mësimi i këngës së re

Dëgjim i muzikës:

1. *Në shkronjë*, ekzekutimi vokalo-instrumental
2. *Në shkronjë*, ekzekutimi instrumental

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse
2. punimi i këngës *Në shkronjë*, sipas procesit metodik me tekstin me nota
3. pjesa përfundimtare

1. Në pjesën hyrëse të orës nxënësit këndojnë një këngë të njohur

2. Punohet kënga *Në shkronjë* sipas procedimit metodik të mësuarit me vesh

3. Kur kënga të jetë përvetësuar, mësuesi do të caktojë solistin, ndërsa pjesën korale do ta këndojnë të tjerët. Nxënësit do të provojnë me radhë rolin e solistit.

Motivi dhe fjalia muzikore

Qëllimi mësimor:

1. thellimi i njohurive për këto nocione
2. dëgjimi analitik i muzikës
3. zbatimi krijues i njohurive

Dëgjim i muzikës:


1. L. van Bethoven: Simfonia nr.9, koha IV, *Odja e gëzimit*

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse
2. bisedë për motivin në muzikë, duke e krahasuar me të shprehurit gojor në kuptimin gjuhësor
3. përjetimi tingullor- karakteristikë e motivit, racionalizimi
4. bisedë për fjalinë muzikore përmes krahasimit me të shprehurit gjuhësor në kuptimin e gjuhës
5. përjetimi tingullor- karakteristikë e fjalive muzikore, racionalizimi
6. pjesa përfundimtare

1. Në pjesën hyrëse të orës mësuesi bisedon me nxënësit për konceptin formë në muzikë në përgjithësi (shikoni shpjegimin në problematikën e formës në muzikë në pjesën e parë të Manualit).

2. Mësuesi mbështetet në tekstin e Tekstit mësimor dhe zhvillon bisedën për motivin në muzikë, duke përdorur *Odjen e gëzimit* si kompozim demonstrues për dëgjimin analitik të muzikës.



3. Në këtë moment ka rëndësi që ky motiv të dëgjohet dhe përjetohet me mendimin muzikor, me fjalinë që ndërton. Mësuesi, së pari me nxënësit dëgjon vetëm motivin, pastaj fjalinë, por mundet edhe me renditje të kundërt – së pari mendimi muzikor, pastaj idenë e saj themelore, motivin muzikor. Mësuesi duhet të ndihmojë që të racionalizojnë këtë përvojë me zërin, duke shpjeguar lidhjen midis motivit të dëgjuar dhe fjalisë. Mënyra se si nga motivi kryesor zhvillohet mendimi muzikor, pra fjalia muzikore do ta tregojë përmes dëgjimit dhe shpjegimit të segmenteve të atij zhvillimi: së pari dëgjojnë motivin në formën burimore, pastaj punën me motivin (përsëritje e ndryshuar) dhe proces i kadencuar. Mësuesi pastaj dëgjon me nxënës motivin dhe fjalinë sipas zgjidhjes së vet dhe përmes dhënies së detyrave dhe përgjigjeve të ofruara përforcon problematikën (të shihet dëgjimi analitik i muzikës).

4 dhe 5. Procesi metodik i këtyre segmenteve të orës është analog me 3 dhe 4. Ka rëndësi që mësuesi të shpjegojë qartë procesin e kadencuar – “sjelljen”, rolin e melodisë, ritmit, elementeve të tjera muzikore në formimin e përfundimit, me kujdes të veçantë në pikësimin muzikor. Ka rëndësi që nxënësit të mos e lidhin përfundimin muzikor vetëm me “pikën”, por me çdo tip të mbylljes së procedimit (duke përfshirë edhe “përfundimet e hapura” në muzikë. Mësuesi mund të shfrytëzojë dy detyra që shtron Harpa- njohja e motivit dhe e fjalive që zhvillohen prej tyre, si shembuj për dëgjimin analitik të muzikës në kuadër të të cilave do të vërtetohet si nxënësit e kanë mësuar problematikën e dhënë.

Këto dy ushtrime janë të lidhura dhe dallohet qartë procedimi. Në ushtrimin e parë, fjalitë me motivet e tyre janë dhënë pjesë – pjesë, kështu që gjatë dëgjimit të fjalisë, nxënësi ushtrohet të dëgjojë edhe motivin; vërtetimi, nëse e ka caktuar drejt vjen menjëherë. Në ushtrimin e dytë, me analizën e tekstit me nota dhe me këndimin, nxënësi ushtron njohjen e motiveve nga të cilat zhvillohen fjalitë. Nëse mësuesi vëren se ka probleme¹⁰ do të zgjedhë vetë shembuj të tjerë dhe sipas parimit të detyrës së parë do të ushtrojë me nxënësit.

6. Përmes zbatimit kreativ të dijeve që kanë përfutur, tani në rolin e krijuesit, nxënësit strukturojnë fjalitë muzikore nga motivet, me të cilat rumbullakohet procesi i njohjes. Mësuesi mund të shkruajë vetë shembuj të rinj dhe t’u japë nxënësve detyrë të ngjashme (për punim në orë ose në shtëpi).

Vërejtje: Nga kjo njësi mësimore dhe më tej, për dallimin e motiveve në fjalitë muzikore mësuesi mund të shfrytëzojë këngët e punuara, si edhe në punimin e këngëve të reja.

Periudha

Qëllimi mësimor:

1. njohja me nocionin *periudhë* në muzikë
2. dëgjimi analitik i muzikës
3. zbatimi krijues i njohurive

¹⁰ Propozimi në vijim nuk duhet të lidhet vetëm me problemet e përvetësimit të dijeve, sepse aktivitetet e propozuara janë shumëfish të dobishme në kuadër të vërtetimit të dijeve në orë të veçantë dhe/ose në kuadër të verifikimit të dijeve.

Dëgjim i muzikës:

1. Zh. Masne, *Meditimi*

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse
2. bisedë për periudhën në muzikë duke e krahasuar me të shprehurit gjuhësor në kuptimin linguistik (gjuhësor)
3. përjetimi tingullor i karakteristikave të motivit, racionalizimi
4. bisedë për fjalinë muzikore përmes krahasimit me të shprehurit gjuhësor në kuptimin linguistik (gjuhësor)
5. përjetimi tingullor i karakteristikave të fjalive muzikore, racionalizimi
6. pjesa përfundimtare

1. Në pjesën hyrëse të orës, mësuesi bisedon për trajtat e ndryshme të të shprehurit të njerëzve dhe e lidh me fenomenin e formës muzikore. Përsërit motivin në muzikë dhe fjalinë muzikore duke futur edhe krahasimin me gjuhësinë.


2. Duke elaboruar Tekstin mësimor, mësuesi e thellon bisedën për formimin e periudhës muzikore, duke theksuar dy pika kryesore: lidhjen specifike të dy fjalive (sinjali i fillimit, përmbajtja e motivit, gjithashtu minimumi i dallimit) dhe formimi i një tërësie të një rendi më të madh.

3. Siç ka qenë rasti gjatë punimit të motivit ose fjalisë, mësuesi me anë të demonstrimit të kompozimit, duke përdorur para nxënësve shembullin e njohur (*Odja e gëzimit*) do t'u japë mundësinë e përjetimit të zërit në kuadër të të cilit nxënësit do të njohin edhe me muzikë, atë për çfarë flet mësuesi:

- *sinjalet e fillimit* (mësuesi duhet të theksojë se është mjaft se janë të njohura, si edhe në shembullin konkret të tregojë se çfarë është ajo përmes të cilës dallojmë ngjashmërinë e fillimit të dy fjalive);
- krahasimi i *rrjedhave muzikore* të dy fjalive duke treguar në "fortësitë" e tyre, d.m.th. se çfarë e bën "më të fortë" konkretisht rrjedhën muzikore në fjalinë e dytë se në të parën- me çfarë plotësohet kushti për periudhën); dhe
- *kadencat* (gjithashtu duke treguar në "forcën"-shembull i përfundimeve të ndryshme, d.m.th."pikësimit muzikor").

Mësuesi, gjatë shpjegimit të përkufizimit të periudhës nga Teksti mësimor duhet të shtojë se edhe tri fjali, sipas të njëjtit parim mund të ndërtojnë një tërësi të një rendi më të madh, si edhe dy periudha, të cilat janë në lidhje mes veti si dy fjali në një periudhë (rrjedha muzikore e periudhës së dytë është "më e fortë" se e para), gjithashtu ndërtojnë një tërësi të rendit më të madh. Në njërën nga orët e ardhshme, kur të punohet problematika e formës muzikore, mësuesi mund ta demonstrojë atë në shembullin me zë sipas zgjedhjes.

Që nxënësit të kuptojnë se çdo të thotë që dy fjali "ndërtojnë një tërësi të rendit më të madh" është e domosdoshme që të arrijnë përjetimin me zë, në kuadër të të cilit fjalitë nuk ndërtojnë një tërësi, çfarë mësuesi e shpjegon përmes demonstrimit të kompozimit nga Teksti mësimor dhe, sipas nevojës, përmes shembujve të tjerë që zgjedh vetë ai.



4. Me zbatimin krijues të njohurive të fituara- njohjen e parimeve në kombinimin e fjalive të dhëna, "duke krijuar" periudhën muzikore (detyra e fundit), mësuesi gjithashtu fiton një pamje mbi cilësinë e njohurive që kanë përvetësuar nxënësit.

Kënga tripjesëshe dhe dypjesëshe

Qëllimi mësimor:

1. njohja me tipin formal të këngës dypjesëshe dhe tripjesëshe
2. dëgjimi analitik i muzikës
3. zbatimi krijues i njohurive

Dëgjim i muzikës:

1. Zh. Masne, *Meditimi*

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse
2. përjetimi me zë i këngës dypjesëshe dhe tripjesëshe, racionalizimi
3. zbatimi krijues i njohurive

1. Në pjesën hyrëse të orës mësuesi mund të bisedojë me nxënësit mbi atë se në jetën e përditshme paraqesim ndonjë ide: së pari e ekspozojmë, paraqesim, pastaj zhvillojmë bisedën për të dhe në fund kthehemi në fillim- esenca në formë konkludimi.

Lidhja krijuese është mes problematikës dhe muzikës, gjë që mund të realizohet gjatë dallimit të tri pjesëve (paraqitja-ndryshimi-përsëritja) të formës tripjesëshe.

2. Pjesa qendrore e orës mund të fillojë me një thellim të mëtejshëm të tekstit në Libër. Gjatë punimit të shembujve me zë është me rëndësi që nxënësit të dallojnë parimin bazë dramaturgjik të këngës: ekspozimi – ndryshimi, përsëritja e pjesës fillestare + përfundimi, d.m.th rrumbullakimi muzikor i të gjithë tërësisë. Përmes shembujve të zgjedhur me zë, mësuesi duhet të tregojë

- lidhjen mes pjesës **a** dhe **b**: në të cilën pjesa **b** sjell kontrast (dhe përse ka rëndësi ndryshimi në kuptimin e ndërtimit të tërësisë muzikore) dhe ku mbetet ngjashmëria me pjesën **a** (element lidhës);
- përpjesëtimi në ekuilibrin mes pjesëve në nivel të përmbajtjes dhe strukturës: nëse është këngë dypjesëshe – në barazinë e shkallës dallimet/kontrastet mes **a** dhe **b** dhe në gjatësi (**a** është periudhë, **b** është periudhë etj.); në rastin e këngës tripjesëshe pjesa **b** mund të jetë më shkurtër se pjesa **a** dhe me një shkallë kontrasti më të vogël;

- variantet e përsëritjes së ndryshuar: përmbledhtas, ekspozim sublim i pjesës **a1**, të zgjeruar (p.sh. me kod etj.). Gjithashtu duhet sqaruar se përse vjen nga këto ndryshime (pjesa **a1** ka funksionin e rrumbullakimit të gjithë këngës);
- procedimet e rrumbullakimit muzikor të tërësisë në këngën dypjesëshe (zgjerim i kodit).

4. Pasi nxënësit kanë "përvetësuar" shembujt për krijimtarinë muzikore duke kënduar dhe ekzekutuar përmendsh, mësuesi vetë do të paraqesë kombinime të ndryshme (të sakta dhe të pasakta), do të tregojë për logjikën adekuate muzikore dhe do të udhëheqë nxënësit në zgjidhjet e duhura, duke zbatuar njohuritë e fituara. Kur të formohen këngët, do të ishte mirë që mësuesi t'u japë nxënësve detyrë shtëpie që të gjejnë pjesë poetike të tilla dhe / ose vepra artistike vizuale (dhe të tjera), të cilat do t'i përgjigjeshin sipas strukturës, dramaturgjisë, stilit të këtyre këngëve duke arsyetuar shkaqet.

Tema me variacione

Qëllimi mësimor:

1. njohja me tipin formal të temës me variacion
2. dëgjimi analitik i muzikës
3. zbatimi krijues i njohurive

Dëgjim i muzikës:


1. S. Rahmaninov, *Variacione në temën e Paganinit*

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse
2. përjetimi me zë i temës me variacione përmes karakteristikave të saj determinuese, racionalizimi
3. zbatimi krijues i njohurive

1. Siç ka qenë rasti në pjesët hyrëse të orës, fokusi i të cilave ka qenë i drejtuar në problematikën e formës muzikore, mësuesi do të bëjë bisedën me nxënësit në kuptimin e lidhjes së mënyrave të ndryshme (formash) të shprehurit të njerëzve me ato të muzikës. Në këtë kuptim do të përsëritë edhe fjalinë muzikore dhe periudhën, duke i krahasuar me mendimin (bisedën) e artikulluar.

2. Në bazë të tekstit në Tekstin mësimor, mësuesi do të thellojë bisedën për natyrën narrative të muzikës, d.m.th. dramaturgjisë së saj. Ka rëndësi që nxënësit të përqëndrojnë vëmendjen në atë se tema është temë vetëm, nëse ka karakteristika të veçanta që i japin veçorinë për të qenë mbartësi kryesor (ose njëri nga kryesorët) i përmbajtjes muzikore të veprës së dhënë. Mësuesi mund të dëgjojë me nxënësit disa tema dhe të ndalet në specifika të caktuara muzikore (melodi,



ritëm, agogjikë, instrumente etj) të cilat temën e bëjnë "temë". Në këtë kuptim do të analizojë gjithashtu edhe temën e Paganinit.

Hapi tjetër është të treguarit e mësuesit në procedimin me variacione.

Do të ishte me leverdi që mësuesi të shkruajë në tabelë karakteristikat e temës së dhënë (tempo, forma, ritmi, tonaliteti, melodia etj) dhe të ndjekë se çfarë ndodh me ato karakteristika të temës në çdo variacion (përmes dëgjimit analitik)¹¹. Qëllimi i këtij procedimi është që nxënësit të kuptojnë procedimin me variacione, që skeleti esencial i temës, i identitetit të saj muzikor mbetet gjithnjë stabil, i njohur, ndërsa në të njëjtën kohë karakteristikat e caktuara të saj ndryshojnë (variojnë). Gjithashtu ka rëndësi që nxënësit të dallojnë procedimet e ndryshme të variacioneve (përmes dëgjimit analitik).

3. Gjatë zgjedhjes së temave, ka rëndësi që ato të këndohen (dhe të ekzekutohen) disa herë. Në vetë punën krijuese, mësuesi mund të zbatojë një procedim të njëjtë si në njohjen me një tip formal të temës me variacion: dallimi i karakteristikave specifike të temës, "identitetit muzikor" të saj, zbatimi i procedimeve të variacioneve të ngjashme si në kompozimin e analizuar (duke kënduar dhe ekzekutuar ai vetë, pastaj zgjedhja e përbashkët që është procedimi me variacion më i përshtatshëm me argumentimin) dhe ana muzikore, ekspozimi i vetë temës. Mësuesi mund t'u japë nxënësve tema të muzikës të njohura për ta, t'i motivojë që, duke kënduar, të ndryshojnë temën dhe të përgatisin shembuj të variacioneve për orën e ardhshme.

Pamja e tabelës

¹¹ Të shihet në fund nën titullin : Pamje e tabelës

Paraqitja skematike e punës së mundshme në shembullin *Variacione në temën e Paganinit*, të S. Rahmaninovit.

Elemente të shprehjes muzikore / Tema/ variacioni	tema	Variacioni nr. 1	Variacioni nr. 2	Variacioni nr. 3	Variacioni nr. 24 (kulmi)
melodia					
ritmi					
tempi					
metri					
tonaliteti					
dinamika					
mënyra ekzekutimit					
forma					
orkestrimi					


Vërejtje: Kjo është paraqitja skematike e punës, ku mësuesi bashkë me nxënësit duhet të përkufizojë karakteristikat sipas elementeve për temën në çdo variacion dhe për t'i shkruar në tabelë. Skema e treguar mund të përdoret në çdo shembull tjetër të temës me variacion.

Instrumentet muzikore

Instrumentet me hark - violina

Qëllimi mësimor:

1. njohja me karakteristikat bazë të instrumenteve me hark
2. njohja me instrumentin muzikor - violinën
3. zbatimi krijues i njohurive



Dëgjimi i muzikës:

1. F. Mendelson, Koncert për violinë dhe orkestër në e-mol
2. J. Brams, *Vallja hungareze*
3. S. Grapeli, *Moonlight in Vermont*

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse
2. bisedë për specifikat e instrumenteve me hark
3. njohja me instrumentin muzikor- violina
4. zbatimi krijues i njohurive

1. Në pjesën hyrëse të orës, mësuesi mundet që me fotografinë e orkestrës simfonike, të bisedojë me nxënës për grupet e ndryshme të instrumenteve dhe të theksojë kriteret sipas të cilave ato grupet ndryshojnë.

2. Lidhësja krijuese me grupin e instrumenteve me hark mund të jetë përmes shembullit me zë me rolin e theksuar të violinës, si edhe bisedën për grupin e instrumenteve me hark: mënyrën e fitimit të tingullit dhe karakteristikës themelore të përbashkët (krahas pamjes vizuale të instrumenteve të këtij grupi), pa u futur në detaje.

3. Pjesa qendrore e orës fillon me bisedën e mësuesit veçanërisht për violinën, duke u fokusuar së pari në pamjen e jashtme, pjesët e instrumentit. Ka rëndësi që mësuesi gjithnjë, krahas të treguarit vizual të pjesës së caktuar të instrumentit ta lidhë çdo pjesë të përmendur me funksionin e saj. Hapi i mëtejshëm është biseda e mësuesit për mundësitë teknike të instrumentit (logjikisht duke u lidhur me ndërtimin specifik të instrumentit), me demonstrim me zë. Duke u nisur nga ajo se nxënësit kanë fituar një njohje të caktuar në llojshmërinë e cilësisë së zërit të instrumentit, mësuesi mund të mbështetet në orkestrat kamertale karakteristike dhe llojshmërinë e mundësive shprehëse të instrumentit, duke komentuar me nxënës shembujt me zë në të cilat violina pasqyron karakter muzikor të ndryshëm. Ky moment është i përshtatshëm për bisedën e mësuesit për historikun e instrumentit, d.m.th. muzikës së shkruar për violinën si edhe bisedën për paraardhësit e saj në linja të shkurtra. Mësuesi bashkë me nxënësit mund të krahasojë karakteristikat e zërit të paraardhësve me atë të violinës, duke u lidhur natyrshëm me bisedën për historikun, si dhe motivimin e kompozitorit për zgjedhjen e violinës.

4. Pjesa përfundimtare e orës është bashkëkohore, në kuptimin e bisedës me nxënës në bazë të shembujve me zë për zhanre të ndryshme muzikore në të cilat përdoret violina (duke theksuar specifikat e tingullit të violinës në raport me zhanre të veçanta). Mbledhja e karakteristikave më të rëndësishme të instrumentit duhet realizuar përmes lojës së njohjes përmes shenjave të theksuara (p.sh. pizz., staccato, flazoleti, kompozimi etj.) në shembujt e shkurtër me zë. Mësuesi mundet që në formë të detyrës së shtëpisë, t'u japë nxënësve që temat e caktuara me karakter të veçantë t'ia besojë violinës, por me mënyrë ekzekutimi të caktuar, të cilën duhet ta caktojnë vetë nxënësit (p.sh. cicërima e zogjve, triler/tremolo, era-flazoleti etj.). Disa nga temat nxënësit mund t'i zgjedhin vetë nga spektri i muzikës popullore që dëgjojnë.

Vërejtje për njësitë mësimore - Instrumentet muzikore

Procedimi metodik i çdo ore ku punohet problematika e këtyre njësive mësimore është identik me atë që dhamë më sipër. Ju kujtojmë se përshkrimi në detaje i çdo hapi të qasjes metodike këtij tipi të njësive mësimore, është i përshkruar në mënyrë precize në pjesën e përgjithshme të këtij Manuali, nën titullin *Instrumentet muzikore*. Gjatë punimit të instrumentit të parë të grupit të caktuar instrumental, siç ishte këtu rasti me violinën- instrumentet me hark, është me rëndësi që në pjesën hyrëse të theksohen karakteristikat e përbashkëta.

Dëgjimi i muzikës

Qëllimi mësimor:

1. zhvillimi i perceptimit auditiv-estetik dhe i mendimit analitik
2. njohja e nxënësve me vepra të rëndësishme të artit muzikor
3. zbatimi krijues i njohurive

Dëgjimi i muzikës:

1. Aleksandër Obradoviq, *Suita nëpër kozmos, Fanfarat e nisjes së anijes në kozmos*
2. Aleksandër Obradoviq, *Suita nëpër kozmos, Ëndrra e yllit të vogël*


Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse
2. bisedë për specifikat e të shprehurit artistik
3. demonstrimi i të shprehurit ekspresiv përmes muzikës dhe dëgjimi analitik i shembujve muzikorë
4. zbatimi krijues i njohurive

Vërejtje: Përshkrimi i detajuar i procedimit metodik të punimit të këtyre njësive mësimore është dhënë në pjesën e përgjithshme të këtij Manuali, nën titullin Dëgjimi i muzikës. Vijnë një orë shembullore e dëgjimit të muzikës, e cila shërben si model.

1. Në pjesën hyrëse të orës mësuesi bisedon me nxënësit mbi format e ndryshme të të shprehurit të njeriut, duke u përqendruar në mediumin artistik. Mundet së bashku me nxënësit të zgjedhë një temë, p.sh. ndonjë kafshë ose ndjenjë, ose ngjashëm dhe përmes demonstrimeve të shkurtra (lexon fragmente poezie, tregon fotografi etj) bisedojnë se si ajo temë është shprehur përmes medimeve të caktuara artistike.

Lidhja krijuese mund të realizohet përmes bisedës për atë se si ajo temë do të mund të shprehej përmes muzikës me, eventualisht, një shembull të shkurtër muzikor.



2. Në pjesën qendrore të orës, mësuesi së pari duhet t'ua tregojë nxënësve sesi tema e caktuar është shprehur me muzikë përmes kompozimit të zgjedhur demonstrues, duke shpjeguar detajisht mjetet muzikore shprehëse, në mënyrën si vijon.

Aleksandër Obradović, *Suitë nëpër kozmos, Fanfarat e nisjes së anijes në kozmos*

Mësuesi u tregon nxënësve tregimin *Suitë nëpër kozmos*: lëshimin e anijes së gjithësisë nëpër kozmosin e panjohur. U shpjegon nxënësve sesi autori i ka menduar Fanfarat (dhe çfarë janë fanfarat) dhe u tërheq vëmendjen, se do t'ua tregojë se sa është me rëndësi pasqyrimi i përshtatshëm i idesë i secilit element muzikor.

Nxënësit së pari dëgjojnë të gjithë pjesën (kohën). Mësuesi thekson karakterin e veprës së dëgjuar.

Bisedon për orkestrën që ekzekuton duke theksuar se për një karakter të tillë, ideja e kompozitorit ka qenë e rëndësishme se ka zgjedhur tamam atë orkestër dhe në mënyrë ekspresive u tregon se si do të dukej, po të dëgjonin ndonjë grup tjetër.

Dëgjojnë një tërësi të shkurtër nga fillimi, me detyrën që të ndjekin me vëmendje zërin e instrumentit dhe orkestrën simfonike. Mësuesi u flet për "sjelljen" e instrumenteve të ndryshme, grupeve instrumentale- të cilat ndahen, ndërrohen apo jo, çfarë rolesh kanë.

Dëgjojnë një tërësi melodike të caktuar. Mësuesi komenton si është linja melodike: e kënduar, e zhvilluar, lirike apo dramatike, e qetë, me qejf etj. dhe në çfarë lidhje është me karakterin e kompozimit. Ky është gjithashtu moment i përshtatshëm për demonstrimin e mësuesit sesi do të dukej, po të ishte e përfytyruar melodina ndryshe, si do të ndikonte në karakterin e kompozimit. Mund të bëjë pyetje dhe a mund të flitet për një linjë melodike "të drejtë" apo më shumë flitet për një varg grupe tingujsh. Gjithashtu u flet sesi është e modeluar ritmiksht dhe si ndikon ritmi në karakterin e tërësishëm.

E dëgjojnë edhe një herë pjesën muzikore. Mësuesi komenton sesi ky shembull muzikor nuk është nga fillimi deri në fund "i sheshtë". D.m.th. se nuk mbaron me të njëjtin intensitet siç fillon, por ndodh gradacioni me kulmimin në fund dhe përshkruan se me cilat mjete muzikore (me dinamikë, me orkestrim, me ritëm).

Vazhdon kompozimi për dëgjimin analitik të muzikës në kuadër të së cilës mësuesi u jep nxënësve detyrat, sipas modelit të tij të komentimit të shembullit të mëparshëm dhe krahas çdo pyetjeje ofron disa përgjigje të mundshme.

Suita nëpër kozmos, Ëndrra e yllit të vogël

Detyrë:

Nxënësit duhet të gjejnë se cili grup ekzekutues është edhe, a dëgjojnë ndonjë instrument specifik (këmbanat, vibrafoni). Mësuesi u lëshon pjesën **"a"** dhe u tregon momentet kur dëgjojnë qartë edhe këmbanat, edhe vibrafoni. Nxënësit nuk duhet ta dinë si quhen këto instrumente, mjafton që mësuesi bashkë me ta konstatojnë se flitet për një orkestër simfonike dhe tingujt e pazakonshëm që prodhojnë dy instrumente (pastaj mësuesi u tregon emrat).

Detyrë:

Mësuesi i pyet të karakterizojnë tempin- i shpejtë, i matur, i ngadalshëm, u lëshon pjesën **"a"** (mjafton vetëm edhe fjalia e parë muzikore).

Detyrë:

Para lëshimit të dytë, mësuesi u jep detyrë të dëgjojnë me kujdes melodinë: a është me kërcim dhe e shqetësuar, e gjallë, e qetë, a do të mund të këndohej me të ose të vallëzohej, nëse është ritmi i njëjtë apo ndryshon. U lëshon incizimin **"a"** dhe **"b"** deri tek përsëritja.

Detyrë:


Kur nxënësit konstatojnë se melodia i ngjan këngës: e ndjeshme, qetësuese, mësuesi i pyet të gjejnë se cilat instrumente e "këndojnë" atë melodi dhe cilat janë në prapavijë dhe e përcjellin; u lëshon vetëm pjesën **"a"**.

Detyrë:

Tani që e njohin atë melodi-këngë, nxënësit duhet të gjejnë, nëse ajo ndërrohet apo përsëritet dhe u lëshon gjithë pjesën. Në momentin kur fillon pjesa **"b"** mësuesi bën pyetjen: A e keni të njohur këtë (po), a është e njëjtë (jo, ndërrohet). Kur fillon përsëritja, mësuesi përsërit pyetjen (nxënësit përfundojnë se është si në fillim). Në fund të këtij dëgjimi mësuesi konstaton se melodia shfaqet tri herë, por në herën e dytë është e ndryshuar, prandaj shembulli ka kështu tri pjesë: *ekspozimi, ndryshimi dhe përsëritja*.

Detyrë:

Gjatë dëgjimit në vijim të të gjithë shembullit, nxënësit duhet të gjejnë se cilat elemente ndërrohen: mësuesi u tregon ndryshimin e grupeve instrumentale në pjesën **"b"**, marrëdhënieve mes tyre, ndryshimin në melodi, dinamikën, agogjikën etj. dhe kur fillon përsëritja duhet të dallojnë se a është plotësisht ashtu si në fillim apo gjatë përsëritjes diçka ndryshon dhe përse (mësuesi u thotë se kjo është për shkak të modelimit të fundit të shembullit, vendosjes së "pikës muzikore" etj. Vetë procesin e "rregullimit të fundit", mësuesi mundet ta analizojë me ta edhe vetëm, duke lëshuar vetëm pjesën **"a"**.



Detyrë:

U bën pyetje si është karakteri i këtij shembulli muzikor: lirik, dramatik, i shqetësuar, qetësues, i pasur apo i varfër me detaje, me kontraste dhe të papritura të mëdha apo i njëjtë. Kur artikullojnë përshtypjen e përgjithshme, mësuesi u thotë se do ta lëshojë edhe një herë shembullin në tërësi dhe të arsyetojnë se a do të mbetet përshtypja e tillë sikur vetëm një nga komponentët e muzikës të ndryshojë (në çfarë do t'u tregojë gjatë shembullit/ p.sh. që melodinë e ekzekuton grupi i instrumenteve me goditje, tempi i shpejtë, dinamika forte etj.). Mësuesi do të duhej në fund të pyesë: cili është roli i atyre dy instrumenteve të pazakonshme, (zilkat dhe vibrafoni) në krijimin e zërit total dhe përshtypjes- nëse e pasuron, nëse e bën të gjithë përshtypjen ngapak jo të përditshme.

Shfaqet momenti kur mësuesi u flet edhe për përmbajtjen jashtëmuzikore- se çdo detaj të kësaj pjese muzikore, kompozitori e ka menduar posaçërisht për të pasqyruar një moment nga udhëtimi nëpër kozmos; dhe ai është ëndrra e një ylli të vogël, prandaj melodia është si këngë, sepse dëgjohet ninulla e cila pastaj zhvillohet, sepse ylli fillon të ëndërrojë... E lëshon edhe një herë dhe shpjegon zgjedhjen e zilkave dhe të vibrafonit.

Në fund të dëgjimit, këta dy shembuj bisedohen me nxënës se si dy pjesët kanë pasur të njëjtat elemente muzikore, të njëjtën orkestër, por që procedimet e ndryshme me të njëjtat elemente muzikore kanë modeluar përshtypje të ndryshme dhe kanë krijuar identitete të ndryshme muzikore.

3. Në fund, mësuesi kthehet në bisedën e fillimit të orës dhe bashkë me nxënësit komenton se si tema e caktuar, ideja, mund të shprehet edhe përmes mediumit të muzikës.

Vërejtje: Autorët e këtij Teksti mësimor rekomandojnë kompozimet e mëposhtme për orët e dëgjimit të muzikës:

- J. S. Bah, *Koralet* (ekzekutim vokalo-instrumental)
- B. A. Moxart, *Ave verum corpus*
- J. Brams, *Vallet hungareze*
- M. Musorgski, *Piktura të një ekspozite*
- S. Prokofjev, *Petja dhe ujku*
- B. Britën, *Drejues për orkestër*
- P. Dika, *Kapela magjistare*
- K. Debysi, *Preludet*
- D. Shostakoviq, *Koncert për trumpetë dhe piano*
- Xh. Gershvin, *Kompozime pianistike*
- A. Obradoviq, *Suitë nëpër kozmos*
- B. Taminxhiq, *Rapsodi për piano, trombë, timpan dhe orkestër dhome*
- Sh. Ognjenoviq, *Polka malazeze*
- H. Hercigonja, *Këngë me valle nga Suita të vogla malazeze*
- A. Pogaçar, *Motiv nga Mali i Zi*
- C. Ivanoviq, *Andante Piacevole për violinë dhe orkestër*

Literatura

Vasileviq, Miodrag, A., *Melodi popullore nga Mali i Zi*. Instituti i muzikologjisë, botim i veçantë, libri 12, Vepra shkencore, Beograd 1965.

Vasileviq, Zorisllava, *Metodika e mësimit të solfezhit*, Universiteti i artit në Beograd, 1978.

Vasileviq, Zorisllava, *Teoria e ritmit*, Universiteti i artit, Beograd, 1985.

Vllahoviq, Vukashin, *Folklori si pikënisje e krijimtarisë artistike në muzikën malazeze*, ITP Unikreks, Nikshiq

Despiq, Dejan, *Instrumentet muzikore*, Universiteti i artit, Beograd, 1982.

Despiq, Dejan, *Teoria e muzikës*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Beograd, 1997

Enciklopedia e veglave muzikore, Znanje, Zagreb, 2005

MUZIKA-*Enciklopedia e instrumenteve muzikore dhe e kompozitorëve të mëdhenj*, JPJ Zemun, 2006

Popoviq, Berisllav, *Forma muzikore dhe domethënia në muzikë*, Klio, Beograd, 1993.

Shoq, Vladimir, *Valle të vjetra popullore malazeze*, Zagreb, 1984

CIP - Каталогизација у публикацији
Централна народна библиотека Црне Горе, Цетиње

371 . 3 :78 (035)

STEFANOVIĆ, Aleksandra

Kultura muzikore : për klasën e pëstë të
shkollës fillore nëntëvjeçare : manuali metodik i
mësuesit / Aleksandra Stefanović, Dijana
Lucellshvab, Nada Ivanović ; [përkthyes Dmitrov
Popović ; ilustrues Dushan Lakiqević] . - Podgoricë
: Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore, 2009
(Podgorica : Studio Mouse) . - 56 str. : ilustr. ;
29 cm + 2 CD

Tiraž 50.

ISBN 978-86-303-1426-1 (broš.)

1. Lucelšvab, Dijana [аутор] 2. Ivanović, Nada
[аутор] . - I. Стефановиќ, Александра v.
Stefanović, Aleksandra

а) Музичка култура - Настава - Методика -
Приручници

COBISS. CG-ID 14725392

